

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7869 E mërkurë 1 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Eshihni se si operon politika serbe sot në lidhje me Kosovën? E patë dje presidentin serb të kapitulluar pas samitit të Berlinit? Por, ai sërish tha: "Ne do të ..."
Vijon në faqen 20

Nga SPARTAK NGJELA

Çfarë mësuam nga samiti i Berlinit?



Opinion *i* **Ditës**

Nga ADELHEID FEILCKE

Një impuls i ri për çështjen e Kosovës?



Përplasje pas samitit të Berlinit

Rama: Meritojmë hapje negociatash. Basha: Kjo qeveri, standarde afrikane

Kryetari i PD: Largimi i Ramës nuk negociohet.
Ballë: Data e zgjedhjeve është më 30 qershor

Ndonëse Samiti i Berlinit dhe takimi i veçantë me kancelaren Angela Merkel nuk rezultoi shumë pozitiv sa i përket hapjes së negociatave këtë qershor, kreu i qeverisë, Edi Rama, ka marrë mbështetjen e socialdemokratëve gjermanë për procesin e integritimit. Gjatë qëndrimit në Gjermani, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, zhvilloi dje një takim me kryetaren ...
Në faqet 3,5

EMRAT/ 360 TRASHEGIMTARET QE MARRIN PARATE E DEMSHPERBLIMIT TE PERNDJEKURIT, KUSH E PERFITON KESTIN E TRETË

Ministria e Financave: 3 muaj kohë për të plotësuar dokumentet. Pasardhësit e ish-të dënuarve politikë duhet të hapin një llogari bankare dhe ta mbajnë aktive



(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë

EMIGRACIONI
Ekspertja: Cilat janë 3 kriteret për të përfutur pension nga Italia
Në faqen 10

HETIMI
Grabitja në Rinas, Ragip Hajdini: Nuk jam unë "Daja" që kërkoni
Në faqen 7

RAPORTI I AMF
Aksidentet, kompanitë paguan 12 milionë euro dëme në 3 muaj
Në faqen 9

FLET SHQIPTARJA
Kandidate për zgjedhjet në Itali: Ditët e para atje ishin traumatike
Suplement

MESAZHI I PRESIDENTIT



Meta: Palët të mos vazhdojnë me pozitat e të fortit, duhet të shmanget greminia
Në faqen 2

Arrestohet 63-vjeçari Skënder Hoxha: Debatuam, nuk durova dhe e qëllova Burri masakron me levë në kokë bashkëshorten

Memaliaj/ Krimi në familje, nëna e 4 fëmijëve gjendet e pajetë në shtëpi

Një 53-vjeçare nga Memaliaj është masakruar nga bashkëshorti me levë në kokë dhe në trup. Krimi i radhës brenda familjes ndodhi në orët e para të mëngjesit të djeshëm, në fshatin Vagat të Memaliajt. Viktima është Antoneta Hoxha, nëna e katër fëmijëve, ndërsa au-



tori i krimit është 63-vjeçari Skënder Hoxha. Menjëherë pas ngjarjes, kryefamiljari u shoqërua në komisariat si i dyshuari kryesor në lidhje me ngjarjen. Fillimisht ai ka deklaruar se gruan e kishte gjetur të pajetë në banesën e tyre dhe se nuk kishte ...
Në faqen 6

KRIZA POLITIKE ZGJIDHJA

Presidenti paralajmëron klasën politike: Vendi buzë greminës, të gjithë të reflektojnë

Kriza, Meta: Pa zgjedhje të lira, nuk ka hapje të negociatave me BE-në

"Takimet janë të rëndësishme për zgjidhjen"

Presidenti Ilir Meta ka bindjen e plotë se pa zgjedhje të lira dhe të barabarta, Shqipërisë nuk do t'i hapen negociatat me BE-në as vitet e ardhshme. Presidenti, i ftuar mbrëmë në "Ora News" ishte mjaft i qartë në përgjigjen e tij lidhur me pyetjen nëse Shqipëria e meriton ose jo hapjen e negociatave me Bashkimin Europian. Sipas kreut të shtetit, pa zgjedhje të lira e të ndershme, nuk ka çelje negociatash as në vitet që do të vijnë. Gjatë një interviste për "Ora News", Meta tha se pozita dhe opozita duhet të fillojnë dialogun e mirëstrukturuar për të gjitha çështjet kyçe të integritetit, në mënyrë që të tregojmë me prova, me rezultate bindëse se Shqipëria e meriton çeljen e negociatave. "Përsa i takon çështjes së standardeve, unë do të dëshiroja që përsëri të isha optimist, por kjo situatë në të cilën ndodhemi, absolutisht që na tregon që shumë standarde të funksionimit të institucioneve në vendin tonë nuk janë aty ku duhet të ishin. Në këtë drejtim, çdo vazhdim në këtë rrugë të gabuar pa një reflektim të të dyja palëve në emër dhe të këtij interesi të përbashkët evropian, përveç interesit kombëtar, interesit social e qytetar, absolutisht që vetëm sa na largon, jo vetëm muajt e ardhshëm, por edhe në vitet e ardhshme", - tha z.Meta. Presidenti kërkoi nga klasa politike që të mos vazhdojë retorikën, pasi vendi mund të rrëshqasë në një krizë të pamundur. "Mendoj që takimet janë të rëndësishme dhe të domosdoshme dhe të gjithë të reflektojnë për të mos vazhduar në retorikat e të fortit atje në tehun e buzës së greminës, sepse këmba mund të rrëshqasë edhe jashtë vullnetit për të përfunduar në një krizë të pamundur. Mungesa e dialogut pa dyshim që do të akumulojë një hendek, që



Presidenti Ilir Meta, gjatë intervistës së djeshme në "Ora News"

do të çojë në kriza. Pa dyshim një problem serioz është mungesa e Gjykatës Kushtetuese dhe problemet e mëdha në sistemin gjyqësor", - tha Meta në intervistë. Sipas tij: "Nuk e dinë çfarë presin më shumë kur sistemi i rregullave të lojës dhe bashkëjetesës demokratike është tronditur rëndë. Në rast se nuk e shohim përpara humnerën, nuk bëjmë gjë tjetër vetëm se përsërisim gabimet që i kushtojnë vendit". Presidenti përmendi se: "Për mua, duhet të ngrihem të paktën në standardet që vendosi Ramiz Alia pas vendosjes së pluralizmit politik në Shqipëri".

Aleatët e Bashës kërkojnë shtyrjen e zgjedhjeve

Grupimi i qendrës së djathtë, Metës: Tryezë dialogu gjithëpërfshirëse

Presidenti, Ilir Meta, merr përsipër të iniciojë një proces dialogu mes mazhorancës dhe opozitës në tentativë për të gjetur zgjidhje për krizën politike. Këtë gjë z.Meta ua bëri të ditur kreut të partive të djathtë gjatë takimit një orësh dje në zyrën e tij. Zyra e shtypit të Presidentit njoftoi se kreu i shtetit ka ftuar palët për dialog, duke e cilësuar mospjesëmarrjen e opozitës në zgjedhje rrezik për pluralizmin. "Presidenti Meta nënvizoi se ka bërë çdo përpjekje për të nxitur zbatimin e reformës në drejtësi brenda kushtetuese që do të garantonte kontrollin e balancën e sistemit në një shtet funksional të së drejtës. Nëse kjo do të kishte ndodhur, kriza aktuale politike nuk do të kishte marrë këto përmasa. Kreu i shtetit shprehu shqetësimin se mosregjistrimi i



të gjitha partive opozitare të legjislaturës së fundit parlamentare rrezikon jo vetëm standartet e zgjedhjeve, por edhe pluralizmin politik në vend" - thuhet në deklaratën e Presidencës. Krerët e partive të djathta ia paraqitën z.Meta platformën politike për arritjen e një marrëveshje kushtetuese. Një ndër propozimet e tyre për zgjidhjen e krizës është ulja e të gjitha partive politike në një tryezë dialogu, duke pranuar të negociojnë edhe me Edi

Ramën, jo në rolin e kryeministrit, por atë të kreut të PS-së. Pas takimit kryerpublikani Fatmir Mediu, tha se në vlerësim të kërkesës së 5 partive dhe qëndrimeve të tyre Presidenti do të ndërmarrë veprimet e veta edhe në diskutim me aktorët e tjerë politikë. "Ndajmë të njëjtin shqetësim që situata është problematike, dhe duhet të pengojmë mos të shkojmë në një konflikt. Presidenti vlerësoi kërkesën e partive tonë, në vlerësim të kërkesës tonë do të marrë qëndrimet e veta në diskutim edhe me palët e tjera. Presidenti është në të njëjtën valë shqetësimi si gjithë qytetarët shqiptarë, por ka edhe angazhimin që palët të gjejnë zgjidhje për të mos shkuar në dem të interesave të vendit", - tha z.Mediu. Dy ditë më parë z.Mediu deklaroi se në takimin me Presidentin do të kërkohet shtyrja e zgjedhjeve.



Krerët e partive të djathta, gjatë takimit të djeshëm me presidentin Ilir Meta

APELI

Pasi takoi krerët e partive politike të Grupimit të Qendrës së Djathtë, z.Meta shprehet se është e domosdoshme vendosja urgjente e dialogut për shmangien e përshkallëzimit të konfliktit, ndërsa sipas tij, pluralizmi politik është në rrezik.



Shtyrja e negociatave, LSI: U ndëshkua korrupsioni qeveritar

Nënkryetari i LSI-së, Petrit Vasili, deklaroi dje se Shqipërisë nuk do t'i hapen negociatat me BE-në qershor. Në një deklaratë për mediat lidhur me diskutimet e Samitit të Berlinit, Vasili tha se përgjigja e Samitit ishte e qartë se vendi ynë praktikisht e ka humbur trenin e Europës dhe shkaktar për këtë është kryeministri Edi Rama dhe rilindja e tij. Sipas tij nuk ka humbur Shqipëria, por Edi Rama dhe politikat e tij thellësisht të gabuara dhe regresive. "Sot nuk ka humbur as Shqipëria dhe as Kosova, por Edi Rama dhe Rilindja e tij, që u munduan të gatuanin një dialog kundër Kosovës dhe tërësisë së saj territorial, sepse e vërteta është që do të vazhdojë, por mbi premisa të reja politike, parimore ku si yll ndriçues, yll polar do të ketë integrimin evropian dhe do të ketë paprekshmërinë e territoreve të shenjta të Kosovës së martirizuar për ato territore. Sot nuk ka humbur Shqipëria, por është ndëshkuar përfundimisht korrupsioni i shfrenuar i Edi Ramës dhe Rilindjes. Sot nuk ka humbur Shqipëria, por ka marrë një grusht ballor kriminalizimi i votës së lirë dhe i ekonomisë nga Rilindja e Edi Ramës. Sot nuk ka humbur Shqipëria, por politika e jashtme antishqiptare dhe anti-integrim e Edi Ramës", tha Vasili.



Valentina Madani

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, shprehu dje keqardhjen për moshapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në në muajin qershor. Sipas tij, Shqipëria nuk mund të përfitojë hapjen e negociatave për shkak të standardeve që sipas tij, janë të nivelit afrikan. "Me Edi Ramën nuk ka integrim në Evropë. Nuk mund të ketë hapje negociatash. Me këto standarde nuk mund të ishtë as në Këshillin e Evropës. Këto janë standarde afrikane. Samiti i Berlinit është i qartë për të gjithë autokratët e Ballkanit, por edhe për njeriun më të korruptuar, Edi Rama, i cili sot synon të na kthejë 10 vite mbrapa duke na kthyer vizat. Fatkeqësisht edhe në këtë qershor, Shqipërisë nuk do t'i hapen negociatat sepse edhe në fushën e ekonomisë, edhe në fushën e shtetit të së drejtës, ka hapa mbrapa", deklaroi z.Basha. Kryedemokrati Lulzim Basha takoi dje nga afër anëtarët e rinj të Partisë Demokratike në degën 12 në Tiranë, të cilëve iu premtoi një të ardhme më të mirë, tek e cila shkohet vetëm duke "larguar qeverinë Rama" siç tha ai. "Nuk ka hapa para, por mbrapa. Këto pasoja i vuajmë shqiptarët e thjeshtë, të rinjtë. Si mund të zgjidhet kjo? Ka vetëm një rrugë, është rruga që nis me dorëzim të sendit të vjedhur tek i zoti. Sendi i vjedhur është vota, i zoti jeni ju", u shpreh z.Basha. Kreu i PD-së aspiron gjithë gjuhën ndaj këtij të fundit kur e quajti "përdhunuesi serial i zgjedhjeve shqiptare, që duhet të largohet njëherë e mirë".

"Largimi i Ramës, i panegociueshëm", kreu i PD-së: Përdhunues serial zgjedhesh

"Standarde afrikane", Basha: Nuk hapen negociatat me BE në qershor

"Samiti, mesazh për autokratët e Ballkanit"



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, me të rinjtë në Farkë



DEKLARATA

"Me Edi Ramën nuk ka integrim në Evropë. Nuk mund të ketë hapje negociatash. Me këto standarde nuk mund të ishtë as në Këshillin e Evropës. Këto janë standarde afrikane. Samiti i Berlinit është i qartë për të gjithë autokratët e Ballkanit, por edhe për njeriun më të korruptuar, Edi Rama, i cili sot synon të na kthejë 10 vite mbrapa duke na kthyer vizat", deklaroi z.Basha.



KUSHTI

Lulzim Basha tha se PD-ja nuk heq dorë nga kushti i saj për largimin e Ramës dhe krijimin e një qeverie transitore. "Është i panegociueshëm largimi i Edi Ramës. Është e vetmja rrugë për të nisur dialogun, një qeveri transitore, një qeveri kujdestare. Për të garantuar reformën në drejtësi. Jo ashtu siç ndodh sot. Dhe mbi të gjitha, me një kryeministër të ri", tha z.Basha.

PADIA



Sulmi ndaj Tufës, PD akuza Ramës si organizator

PD-ja dënon sulmet ndaj Institutit për Studimin e Krimeve dhe Paspajave të Komunizmit dhe drejtuesit Agron Tufa. PD-ja shprehet se dekomunizimi nuk duhet të ndalet nga përpjekjet e Edi Ramës për t'i imponuar parlamentit shkriren e të vetmit institut të pavarur, që po punon për të zbuluar të vërtetën e krimeve të komunizmit. Kreu i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Paspajat e Komunizmit, Agron Tufa, ka paditur në Gjykatën e Tiranës disa persona, të cilët ai i akuzon se e kanë sulmuar, fyer dhe kanë shpifur ndaj tij.

AKUZA

Kreu i PD-së aspiron gjithë gjuhën ndaj kryeministrit Rama kur e quajti "përdhunuesi serial i zgjedhjeve shqiptare, që duhet të largohet njëherë e mirë".

Samiti, Berisha: "Gangsterët" e Ballkanit morën në Berlin atë që meritonin

Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se ka ndërhyrë për të manipuluar lajmet negative dhe që nuk i pëlqeni, në "Facebook"-un e medias zyrtare shtetërore gjermane "Deutsche Welle". Ish-kryeministri Sali Berisha komentoi zhvillimet e Samitit të Berlinit. Me tone të ashpra kundër presidentit Thaçi dhe kryeministrit Rama, Berisha shkruan se "Samiti i Berlinit me qëndrimin e tij të prerë kundër Serbisë së Madhe dhe copëtimin të Kosovës ka zhgënjyer shumë Presidentin serbomadh Vuçiq dhe argatët e tij në këtë projekt, Miladinin shqipfolës, pra argatin e tij në Prishtinë dhe Zografin bis, argatin e tij të Tiranës! Të tre këta të mbe-



Ish-kryeministri Sali Berisha

tur duarbosh dhe të damkosur si sherrxhinj, që për karriget e tyre duan të ndezin me projektin e Serbisë së Madhe konflikte të reja në Ballkan, përveçse me fotot e tyre fytyrënxira që bëjnë xhiron e mediave ndërkombëtare, u vunë në garë për të shpërndarë lajme sa më të këqija e të deklarojnë se

'samiti ishte i rëndë', se 'nuk solli asnjë rezultat konkret', se 'nuk ka pasur asnjë përparim' dhe se 'ish-te zhgënjyes'. Shkruan Berisha, ndërsa e mbyll statusin e tij duke i konsideruar Ramën e Thaçin si "gangster të Ballkanit", që në Berlin morën atë që meritonin.

një parlament të qytetarëve. Për të garantuar që gjyqtarë dhe prokurorë, drejtësia shqiptarë të veprojnë siç e parashikua në reformën në drejtësi, jo siç janë kapur

sot 40 mijë çështje në Gjykatën e Lartë, me mijëra çështje pronash", u shpreh kreu i PD-së. **PREMTIMET** Kryetari i Partisë Demo-

kratike, Lulzim Basha, nga Farka ku bashkëbisedoi me të rinjtë përmendi se opozita e bashkuar ka protestuar dhe do të protestojë sërish, me qëllim që të dëbojë këtë

bandë kriminale. Basha tha se në krye të vendit është Rama dhe banda e tij, e cila qeveris me kërbac e duke bashkëpunuar me krimin. Në fjalën e tij, Basha paralajmëroi se më datë 12 maj, kjo bandë kriminale do të tundojë. "Kjo bandë kriminale më datë 12 maj do të dëbohet. Ka ardhur koha që të bëhet e qartë si e ndarë me thikë, dallimi mes një bande kriminale në pushtet dhe asaj që ne duam të bëhet kur të qeverisim nesër. Kjo bandë me në krye Ramën bashkëpunon me krimin, kurse ne premtojmë dhe realizojmë sipas standardeve më të mira europiane", theksoi z.Basha. Lulzim Basha theksoi se me ardhjen në pushtet të tij, do të bëhen subvencione në bujqësi, do të ketë ndryshime radikale pozitive, sipas standardeve europiane. Ai premtoi nisjen e një të ardhmeje europiane për Shqipërinë dhe largim, sipas tij, të atyre që e duan vendin të zhytur në krim e korrupsion. "Duke çliruar ekonominë, qeverisjen nga krimi, ne do të kthejmë mundësi për punësim. Do i kthejmë bujqësisë, sektorit që punëson shumicën e shqiptarëve, jo thjesht shpërsën, po do ju japim subvencione direkte pa nipt, pa burokraci, vetëm me kartë identiteti, njësoj si Maqedonia e Kosova".

EPSA SHOQERIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANIMIT PËR:

"Ullishte (Trull)" me sip. 14,700 m², Nr. Pasurie 56/3, Vol.29, Fq.15, ZK 8605, i ndodhur në Vlorë 5, Vlorë dhe "Objekt karabina 4 Kat + 1 Kat bodrum" me sip. 1,262 m², Nr. Pasurie 56/3-ND, ZK 8605, i ndodhur në L.11 Janari, Vlorë në pronësi të Shkollës Internacionale shpk. Këto pasuri janë hipotekuar në favor të Banka ProCredit sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankaniti është 3,135,524 Euro. Ankaniti zhvillohet datë 09.05.2019 ora 16.00 në adresën Rr. "1 Qemali", Pall. "Fratarit", K.6, Tiranë. **Per cdo informacion mund të kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne web www.epsa.al.**

ZGJEDHJET TË MAJTËT

Partitë aleate kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit elektoral

PS zyrtarizon koalicionin "ASE" me 23 aleatë, lihen jashtë komunistët

Partitë bien dakord të mbështesin kandidatët e përbashkët

Partia Socialiste do të garojë në zgjedhjet e ardhshme lokale bashkë me një koalicion partish aleate që do të titullohet sërisht "Aleanca për Shqipërinë Europiane". Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste Taulant Balla ka firmosur dje marrëveshjen e bashkëpunimit dhe konkurrimit në një koalicion me 23 kryetar partish, të cilët në 30 qershor do mbështesin kandidatët e përbashkët për kryetar bashkie. Në dokumentin e dakordësuar thuhet se partitë nënshkruese të këtij dokumenti formojnë me vullnet të plotë politik koalicionin Zgjedhor "Aleanca për Shqipërinë Europiane" dhe se objektivi i koalicionit është fitorja e zgjedhjeve administrative të 30 qershorit 2019. Gjithashtu, koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" e konsideron zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme si objektivi parësor të procesit të votimeve për organet e pushtetit vendor në 30 qershor 2019. Anëtarët e këtij koalicioni jo vetëm garantojnë përkushtimin ndaj këtij qëllimi të partive që janë pjesë e këtij bashkëpunimi, por i bëjnë thirrje çdo subjekti politik, brenda dhe jashtë garës t'i shërbejnë këtij objektivi. Më tej partitë aleate në këtë marrëveshje theksojnë se "mospjesëmarrja në zgjedhje e disa subjekteve nuk është përgjegjësi e qeverisë, por e llogarive të gabuara dhe kundërproduktive të lidershipit të këtyre subjekteve që interesat e ngushta personale i kanë vënë mbi interesat kombëtare". Gjithashtu, në këtë marrëveshje ato shprehin se "dhuna mbi zgjedhjet dhe përsëritje e skenarëve të vitit '96 mbi vullnetin e zgjedhësve nuk do të tolerohet jo vetëm nga qytetarët dhe organet shtetërore, por edhe nga komuniteti ndërkombëtar".

BASHKËPUNIMI

Ndërkohë që në bazë të këtij dokumenti përcaktohet se të gjitha mandatet që mund të fitojnë partitë aleate të PS, në këtë koalicion për këshilltarë bashkiake, në çdo bashki të vendit, do të jenë në harmoni të plotë me politikat dhe strategjitë e aktivitetit të grupit të këshilltarëve të koalicionit "ASE". Nga ana e saj Partia Socialiste e Shqipërisë garanton aleatët se përfaqësuesit e saj në Komisionet zgjedhore dhe të numërimit të votave do të numërojnë dhe ruajnë me korrektesë çdo votë të partive aleate.

Gjithashtu, PS pranon se është e gatshme që pas fitores në zgjedhjet e 30 qershorit 2019 për të integruar në programet qeverisëse të kryetarëve të bashkive dhe këshillave përkatës çdo kontribut dhe projekt zhvillimi vendor që pasqyrojnë vullnetin zgjedhor ndaj çdo subjekti pjesë e këtij koalicioni.

Po ashtu PS garanton se do të përfshijë në administrimin qeverisës çdo individ me nivel të lartë profesional dhe moral që kontribuon politikisht në radhët e partive të këtij koalicioni.

KOALICIONI

Koalicioni i shpallur dje përmban në total 24 forca politike, ose afërsisht

gjysmën e subjekteve të regjistruara në KQZ. Në përgjithësi pjesë e koalicionit janë bërë parti tradicionale aleate të PS-së, si PDS e Paskal Milos, PSD e Skënder Gjinushit, PSM e Gjergj Kojës, PUK e Idajet Beqirit, etj. Por nuk kanë munguar në këtë koalicion edhe forca që në zgjedhjet e shkuara ishin pjesë e koalicionit të PD-së, siç është rasti i MEGA-s apo Partia Demokratia e Re Europiane e Koçi Tahirit. Kujtojmë se ky i fundit në zgjedhjet 2017 ishte pjesë e listave të kandidatëve të PD-së dhe që tashmë ka vendosur të pranojë mandatin duke u futur në Kuvend. Nga ana tjetër PS ka lënë jashtë koalicionin Partinë e Punës dhe Partinë Komuniste. Ndonëse në tryezën e para dy muajve Partia e Punës së Shqipërisë dhe Partia Komuniste e Shqipërisë - 8 Nëntori ishin pjesë e tryezës së thirrur nga PS, ato nuk figurojnë në listën e partive që përbëjnë koalicionin zyrtar të PS.



Aleatët duke dalë nga selia e PS-së

KOALICIONI "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE"

1. Partia Socialiste - Edi Rama
2. Partia Social Demokratike - Skënder Gjinushi
3. Partia Demokratia Sociale - Paskal Milo
4. Aleanca Popullore - Artur Dojaka
5. Partia Socialiste e Moderuar - Gjergj Kojë
6. Aleanca Demokratike - Eduard Abazi
7. Partia e Gjelbër - Edlir Petani
8. Partia e Unitetit Kombëtar - Idajet Beqiri
9. Partia G99 - Redi Shtino
10. Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet - Gaqo Apostoli
11. Partia Ardhmëria Shqiptare - Emin Subashi
12. Partia Për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve - Ymer Kurti
13. Partia Socialpunëtore e Shqiptare - Ramadan Ndreka
14. Partia e Reformave Demokratike Shqiptare - Skënder Halili
15. Partia e të Drejtave të Mohuara - Ilir Vata
16. Aleanca për Barazi e Drejtësi Europiane - Valentino Mustaka
17. Partia Demokratike për Integrim dhe Prosperitet - Kujtim Muça
18. Partia Kristiandemokrate - Dhimitër Mustia
19. Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare - Genci Sakaj
20. Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen - Kristo Kiço
21. Partia Demokratia e Re Europiane - Koçi Tahiri
22. Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian - Edmond Themelko
23. Aleanca Arbnore Kombëtare - Gjet Ndoji
24. Partia e Pajtimit Kombëtar - Spartak Dobi

ALEATËT

Nuk kanë munguar në këtë koalicion edhe forca që në zgjedhjet e shkuara ishin pjesë e koalicionit të PD-së, siç është rasti i MEGA-s apo Partia Demokratia e Re Europiane e Koçi Tahirit. Kujtojmë se ky i fundit në zgjedhjet 2017 ishte pjesë e listave të kandidatëve të PD-së dhe që tashmë ka vendosur të pranojë mandatin duke u futur në Kuvend.



Tryeza e aleatëve të Partisë Socialiste

MARRËVESHJA, PS ANGAZHOHET TË PUNËSOJË INDIVIDËT ME VLERA NGA ALEATËT

Ne respektim të programit politik, Partia Socialiste e Shqipërisë si drejtuese e këtij koalicioni garanton:

- a. Të gjitha mandatet që mund të fitojnë partitë aleate të PS, në këtë koalicion për këshilltarë bashkiake, në çdo bashki të vendit, do të jenë në harmoni të plotë me politikat dhe strategjitë e aktivitetit të grupit të këshilltarëve të koalicionit "ASE".
 - b. Vullnet të plotë për të bashkëpunuar me subjektet politike, shoqatat, sindikatat apo individë që janë të gatshëm të kontribuojnë për një qeverisje efektive, transparente dhe të ndershme vendore.
 - c. Partia Socialiste e Shqipërisë garanton aleatët e saj se përfaqësuesit e saj në Komisionet Zgjedhore dhe të numërimit të votave do të numërojnë dhe ruajnë me korrektesë çdo votë të partive aleate.
 - d. Partia Socialiste pas fitores në zgjedhjet e 30 qershorit 2019 është e gatshme për të integruar në programet qeverisëse të kryetarëve të bashkive dhe këshillave përkatës çdo kontribut dhe projekt zhvillimi vendor që pasqyrojnë vullnetin zgjedhor ndaj çdo subjekti pjesë e këtij koalicioni.
 - e. Partia Socialiste garanton se do të përfshijë në administrimin qeverisës çdo individ me nivel të lartë profesional dhe moral që kontribuon politikisht në radhët e partive të këtij koalicioni.
 - f. Partia Socialiste kërkoi nga aleatët që të garantojnë mbështetjen për programin politik dhe projektet vendore që ajo premtom të realizojë gjatë qeverisjes lokale 2019-2023.
- Me vetëdijen e përbashkët, për domosdoshmërinë e intensifikimit të procesit të integritetit të Shqipërisë në Familjen Europiane, përmes zgjerimit të konsensusit politik.**

Vendosëm sa më poshtë:

- Të themelohet në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të 30 qershorit 2019 koalicioni politik zgjedhor me emrin "Aleanca për Shqipërinë Europiane". Shkronjat nistore të koalicionit do të jenë "ASE".
- Partitë anëtare të koalicionit angazhohen të bashkëpunojnë në çdo nivel politik për maksimalizimin e rezulttit zgjedhor; anëtarët e koalicionit angazhohen që pas fitores në zgjedhje, të kontribuojnë në të gjitha nivelet e qeverisjes vendore në bazë të peshës specifike të secilës parti politike bazuar në platformën e bashkëpunimit të negociuar nga çdo parti pjesëtare e koalicionit;
- Partitë anëtare të koalicionit autorizojnë kryetarin e Partisë Socialiste, z. Edi RAMA, të zgjerojë koalicionin edhe me parti të tjera politike, pa pasur nevojë për miratimin tonë me shkrim duke i përfshirë vullnetet e tyre për t'iu bashkuar këtij koalicioni në anekset shoqërore, pjesë integrale e kësaj marrëveshje;
- Kryetari i Partisë Socialiste, Edi Rama, autorizohet të kryejë çdo veprim ligjor në lidhje me regjistrimin e koalicionit në KQZ si subjekt zgjedhor, regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie, pa pasur nevojë për nënshkrimin e kërkesës nga secili anëtar i këtij koalicioni si dhe çdo veprim tjetër që kërkon ligj për koalicionet, përfshirë edhe delegimin e të drejtës për të caktuar vëzhgues në KZAZ, KQV dhe VNV, bazuar në dispozitat e caktuara nga Kodi Zgjedhor dhe rregullat përkatëse të miratuara nga KQZ;
- Përfaqësuesi i Partisë Socialiste në KQZ, z. Eridjan Salianji, autorizohet nga të gjitha partitë pjesëmarrëse të koalicionit zgjedhor për të përfaqësuar koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit.



Ndonëse Samiti i Berlinit dhe takimi i veçantë me kancelaren Angela Merkel nuk rezultoi shumë pozitiv sa i përket hapjes së negociatave këtë qershor, kreu i qeverisë, Edi Rama, ka marrë mbështetjen e socialdemokratëve gjermanë për procesin e integritimit. Gjatë qëndrimit në Gjermani, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, zhvilloi dje një takim me kryetaren e Partisë Socialdemokrate, Andrea Nahles, ku u diskutua procesi i integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Rama e njohu Nahles me reformat e ndërmarra nga qeveria shqiptare dhe prishmërinë për një përgjigje pozitive nga vendet anëtare të BE-së për hapjen e negociatave. Sipas njoftimit të zyrës së shtypit të Kryeministrit, zonja Nahles siguroi Ramën për

Kreu i qeverisë mori mbështetjen e socialdemokratëve gjermanë

Rama në Gjermani: Shqipëria meriton çeljen zyrtare të negociatave



Shqipëria meriton njohjen e arritjeve të derikutshme, përmes çeljes zyrtare të negociatave për anëtarësim", - shkroi kreu i qeverisë në "Twitter". Por, pavarësisht këtyre mesazheve, duket se situata nuk është shumë e favorshme për vendin tonë sa i përket procesit të hapjes së negociatave. Mediat gjermane, por edhe burime pranë takimit Rama-Merkel bënë të ditura dy ditë më parë se Gjermania ka shtyrë vendimmarrjen për këtë çështje për në shtator. Gjatë qëndrimit në Berlin, kryeministri pati një takim edhe me eurodeputetin Knut Fleckenstein.

mbështetjen e pakushtëzuar të grupit socialdemokrat për hapjen e negociatave mes Shqipërisë dhe Bashkimit Europian. Liderja e Partisë Socialdemokrate, njëkohësisht dhe kryetare e grupit parlamentar, përgë-

zoi kryeministrin shqiptar për reformat e ndërmarra dhe u shpreh besimplotë për një vendim pozitiv në qershor. Rama takoi edhe nënkryetarin e grupit parlamentar të CDU, Johann Wadephul. "Mesazh i qartë:

Kreu i grupit të PS nuk e ka përjashtuar mundësinë e një marrëveshjeje Rama-Basha

PS: Nuk ka negociata në kurriz të Kushtetutës, zgjedhjet në 30 qershor

"Nuk jam Nostradamus, por di që afatet zgjedhore janë kushtëzuese"

Partia Socialiste nuk pranon të ulet në asnjë tryezë negociatash, që synojnë një marrëveshje që shkel Kushtetutën. Ndërsa aleatët e PD-së janë angazhuar ditët e fundit në krijimin e një tryeze negociatash me angazhimin edhe të Presidentit të Republikës, kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, mohoi dje çdo mundësi për të zhvilluar negociata me askënd në kurriz të Kushtetutës. Duke iu përgjigjur interesimit të mediave lidhur me takimin e zhvilluar dje në Presidencë dhe nismës për të ulur në një tryezë liderin e mazhorancës dhe opozitës, Balla theksoi se zgjedhjet do të mbahen në 30 qershor, duke lënë të kuptohet se s'mund të ketë marrëveshje që cenon dekretrin për përcaktimin e datës së zgjedhjeve apo që vë në diskutim legjitimitetin e mazhorancës aktuale qeverisë dhe parlamentare. "Mandati i parlamentit është tejet legjitim. Do të doja të përsërisja, ka qenë shumë i qartë qëndrimi i SHBA-ve përmes Palmeri, i cili ishte në Shqipëri para pak javësh, apo edhe qëndrimi i BE-së, që nxit të gjitha partitë të marrin pjesë në zgjedhje. Zgjedhjet do të zhvillohen më 30 qershor. Zgjedhjet janë të gjithëpranuara me këdo që merr pjesë dhe ajo që është shumë e rëndësishme. Gjej rastin të ritheksoj edhe njëherë se nuk ka asnjë forcë politike që mund të tentojë të pengojë zhvillimin e zgjedhjeve të lira demokratike", - deklaroi socialisti Balla. Ndërkohë që pyetjes së gazetarëve nëse do të kishin një marrëveshje të ngjashme si ajo e 2017-ës mes Ramës dhe Bashës, ai nuk pranoi t'i përgjigjej prerë,



Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla

por theksoi se afatet kushtetuese zgjedhore nuk do të preken. "Unë nuk jam Nostradamus, por di që në çdo rast afatet zgjedhore janë kushtëzuese. Kush mendon se mund të marrë pushtet në tavolinë, kush mendon se mund ta përdorë Kushtetutën apo Kodin Zgjedhor si një alibi për humbjen e radhës e ka shumë gabim. Afatet e Kodit Zgjedhor dhe Kushtetutës janë shumë të qarta. Nuk ka negociata me askënd mbi kurrizin e Kush-

tetutës. Sikurse bënë gabimin e paimagjinueshëm për dorëzimin e mandateve të besuara nga populli, tani jemi në fazën që PD dhe LSI, Lulzimi dhe Monika duan që t'u heqin të drejtën qytetarëve për të votuar kryetarët e 61 kuvendëve të bashkive të vendit. Kjo nuk ka për të ndodhur. Zgjedhjet e 30 qershorit do të zhvillohen", - deklaroi Balla. Ndërkohë që ai edhe një herë përcolli mesazhin që po i mëshon me së

shumti mazhoranca ditët e fundit, se kushdo që do tentojë të prishë zgjedhjet, do të përballlet me forcën e ligjit. Kjo, nisur pikërisht nga kërcënimet e opozitës se nuk do lejojë mbajtjen e zgjedhjeve. "Parashikimet e Kodit Penal për ata që bllokojnë rrugë, pengojnë zgjedhësit të shkojnë në votim janë shumë të qarta dhe unë sa herë të komunikoj me ju, deri në 30 qershor do t'ua rikujtoj: Kush tenton të pengojë zgjedhësit për të shkuar në votim, apo kush tenton apo guxon të prejë një qendër votimi apo kutinë e votimit, dënimit shkojnë nga 5 deri në 8 vite burg", - u shpreh Balla. Nga ana tjetër, ai ka theksuar se pavarësisht se opozita e vërtetë nuk merr pjesë në zgjedhje, në 30 qershor përballë koalicionit të PS-së do ketë subjekte të tjera, madje ai ka bërë të ditur se do ketë edhe koalicionë zgjedhore. "Kjo aleancë është gjysma e partive që marrin pjesë në zgjedhje. Jam i sigurt se do ketë aleanca e koalicionit të tjerë në zgjedhje. Nuk kam asnjë koment lidhur me aleanca apo koalicionë që ngrihen mbi parimin e kundërshtimit të votës së popullit", - tha Balla.

Kryeministri refuzon titullin "Qytetar Nderi" i Dibrës

Kryeministri Edi Rama ka refuzuar dje titullin "Qytetar Nderi" i dhënë nga Bashkia e Dibrës, në shenjë mirënjohjeje për nisjen e punimeve për ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Menjëherë pasi Këshilli Bashkiak i Dibrës votoi me shumicë votash dhënien e këtij çmimi, kryeministri Edi Rama ka reaguar nëpërmjet zyrës së tij të shtypit, ku ka bërë të ditur se nuk mund ta pranonë këtë vlerësim. Në një reagim të shpejtë për mediat, zyra e shtypit e kryeministrit sqaroi edhe motivin e refuzimit. Sipas saj, kryeministri nuk pranon titujt për zyrtarët që janë ende në detyrë, pavarësisht qëllimit të mirë të tyre. "Kryeministri Rama ka qenë, mbetet dhe do të jetë gjithmonë kundër titujve honorifikë për politikanët në detyrë. Duke falënderuar të gjithë ata që mund të jenë nisur për mirë, kryeministri Rama e refuzon titullin e 'Qytetarit të Nderit', dhënë sot nga Bashkia Dibrë", deklaroi kryeministria. Në mbledhjen e djeshme, Këshilli i Bashkisë Dibrë i akordoi titullin "Qytetar Nderi" i Bashkisë, kryeministrit Edi Rama. Propozimi i bërë nga një prej këshilltarëve ka marrë 16 vota pro dhe 4 kundër, nga 20 anëtarë të pranishëm në këtë mbledhje. Si motivacion është paraqitur ndërtimi i Rrugës së Arbrit, megjithëse kjo veprë ende nuk ka përfunduar. Punimet për Rrugën e Arbrit nisën vitit të kaluar dhe Rama premtoi se do të mbylleshin brenda katërveçarit të tij qeverisë, pra deri në 2021-shin.



NEGOCIATAT
"Nuk ka negociata me askënd mbi kurrizin e Kushtetutës. Sikurse bënë gabimin e paimagjinueshëm për dorëzimin e mandateve të besuara nga populli, tani jemi në fazën që PD dhe LSI, Lulzimi dhe Monika, duan që t'u heqin të drejtën qytetarëve për të votuar kryetarët e 61 bashkive dhe 61 kuvendëve lokale të bashkive të vendit. Kjo nuk ka për të ndodhur. Zgjedhjet e 30 qershorit do të zhvillohen", - deklaroi Balla.

Arrestohet 63-vjeçari Skënder Hoxha: Debatuam, nuk durova më dhe e godita. Nuk doja që ajo të vdiste

Burri masakron me levë në kokë bashkëshorten

Nëna e 4 fëmijëve, Antoneta Hoxha u gjet e pajetë brenda në banesë

MEMALIAJ

Një 53-vjeçare nga Memaliaj është masakruar nga bashkëshorti me levë në kokë dhe në trup. Krimi i radhës brenda familjes ndodhi në orët e para të mëngjesit të djeshëm, në fshatin Vagalat të Memaliajt. Viktima është Antoneta Hoxha, nënë e katër fëmijëve, ndërsa autori i krimit është 63-vjeçari Skënder Hoxha. Menjëherë pas ngjarjes, kryefamiljari u shoqërua në komisariat si i dyshuari kryesor në lidhje me ngjarjen. Fillimisht ai ka deklaruar se gruan e kishte gjetur të pajetë në banesën e tyre dhe se nuk kishte lidhje me ngjarjen, por më pas ka pranuar gjithçka. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se dyshohet që krimi ka ndodhur pas një konflikti në çift. Burri vrasës është vënë në pranga, ndërsa akuzohet për veprën penale "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare".

VRASJA

Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, policia është sinjalizuar se shtetësjja Antoneta Hoxha është gjetur e pajetë në banesën e saj. Menjëherë pas sinjalizimit, blutë kanë shkuar në vendngjarje dhe pas këqyrjes së kufomës, kanë konstatuar se kishte dëmtime në kokë dhe në trup. "Pas njoftimit të marrë se shtetësjja A.H., banuese në fshatin Vagalat, Bashkia Mema-



Viktima Antoneta Hoxha

liaj, u gjet nga familjarët e pajetë në banesë, me dëmtime në kokë, menjëherë u ngrit grupi hetimor, ku në bashkëpunim prokurorinë kryen veprimet e para procedurale. Në përfundim të veprimeve të para hetimore, specialistët e Stacionit të Policisë Memaliaj nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit S.H., 63 vjeç, i cili ka vrarë bashkëshorten e tij, shtetasen A.H., 53 vjeçe. Materialet i kaluan prokurorisë

për hetime të mëtejshme", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkaq, burime për "Gazeta Shqiptare" sqaruan se fillimisht bashkëshortët kanë debatuar ashpër me njëri-tjetrin për motive ende të paqarta. Në grindje e sipër, Skënder Hoxha e ka goditur bashkëshorten me levë pas koke dhe më pas në ballë dhe në krahun e majtë, duke e lënë të vdekur në vend. Vetëm disa orë pas ngjarjes, agresori ka pranuar se ka vrarë nënën e fëmijëve të tij,

"Mos e kapni me dorë, e kanë vrarë", kryeplaku tregon bisedën me burrin

MEMALIAJ - Kryeplaku i fshatit Vagalat, Hodo Hoxha, personi që njoftoi policinë ka treguar për kamerën e "ABC News" se e ka gjetur viktimën të mbuluar me gjak. Hoxha tha se e kishte lajmëruar burri i 53-vjeçares për ngjarjen e rëndë. Mësohet se çifti kishte katër fëmijë dhe siç tregoi kryeplaku i fshatit, ata nuk kishin pasur probleme më parë mes njëri-tjetrit.

Kryeplaku: Unë i lajmërova. Kur erdhëm ne, ka ardhur në orën 4 i shoqi në shtëpi dhe ka thënë 'hajde se ka vdekur Neta'. U ngritëm me gruan, vajtëm aty dhe e pamë. Çfarë të shikoje, se ishte e mbuluar me gjak. Mos e kapni me dorë - tha - se e kanë vrarë'. Kaq na tha.

-E ka vrarë vetë ai?
Kryeplaku: Nuk e di. S'ta shpjegoj dot atë. E kanë vrarë tha.

-A kishin probleme me



Kryeplaku Hodo Hoxha

përpara?

Kryeplaku: Nuk kishin probleme.

-Sa fëmijë kishte çifti?

Kryeplaku: Kishin një djalë dhe tri vajza. Vajzat i ka të martuara dy në Greqi, një nënë në Tiranë.

-E kenë gjetur të glakosur viktimën?

Kryeplaku: Kur erdha unë në orën katër ishte gjaku i ngrirë.

"Debatuam, nuk durova më dhe e godita. Nuk doja të vdiste", ka deklaruar 63-vjeçari. Mësohet se çifti kishte disa ditë që kishte shkuar në fshatin Vagalat nga kryeqyteti, ku banonin.

Nuk dihet shkaku i kthimit të tyre në fshat. Pas ngjarjes së rëndë, policia dhe prokuroria po punojnë intensivisht për zbardhjen e plotë të rrethanave dhe motivit të kësaj ngjarjeje.

Hetuesit: Dy viktimat u vranë pas një sherri banal

Ekzekutimi i dy kushërinjve Jushi në Laç, vetëdorëzohen në polici tre autorët e krimit

KURBIN - Dy ditë pas vrasjes së dyfishtë të ndodhur në lagjen nr.1 të qytetit të Laçit, janë dorëzuar në polici tre autorët e krimit. Ngjarja e rëndë ndodhi mbrëmjen e së dielës, ku pas një sherri të çastit mbeten të vrarë kushërinjtë Kelvin dhe Erjon Jushi. Burime zyrtare nga policia dje bënë të ditur se falë negociatave me familjarët është bërë i mundur vetëdorëzimi i Markel dhe Vinçens Bushit, përkatësisht, 25 dhe 28 vjeç, kushërinj me njëri-tjetrin. Ndërsa 23-vjeçari Manuel Bushi është dorëzuar në orët e pasdites.

Tre të rinjtë akuzohen për veprat penale "Vrasja në rrethana të tjera të cilësuar, në bashkëpunim" dhe "Mbajtja pa leje e

armëve dhe municioneve luftarake". Vëllëzërit Markel dhe Manuel Bushi dhe djali i xhaxhait të tyre, Vinçens (Pali) Bushi, u identifikuan nga policia disa orë pas vrasjes përmes kamerave të sigurisë në lokalit ku ndodhi ngjarja. Kelvin dhe Erjon Jushi, të njohur edhe me emrat, Mikel dhe Jani, djem xhaxhallarësh, u qëlluan me pistoletë pas një sherri në lokal. Dyshohet se gjithçka ka nisur nga një debat që i riu Manuel Bushi ka pasur me dy personat që mbeten të vrarë. 23-vjeçari ka lajmëruar vëllain e tij dhe djalin e xhaxhait, të cilët kanë shkuar në lokal me armë. Personat e përfshirë në konflikt, tre autorët dhe dy viktimat kanë dalë në ambientet e jashtme të lokalit për t'u sqaruar, por situata është

agruar duke bërë që të nxjerrin armët. Kelvin dhe Erjon Jushi, përkatësisht 30 dhe 36 vjeç kanë tentuar të largohen me shpejtësi, pasi kanë parë që dy të rinjtë ishin të armatosur. Sipas policisë, vrasja ndodhi për motive banale pas një konflikti të çastit. Personazhet e përfshira në këtë vrasje të dyfishtë tregojnë se kjo ngjarje nuk ishte krejt e papritur. Bëhet fjalë për persona me precedentë penalë, madje edhe në kërkim nga policia, që lëviznin të armatosur dhe frekuentonin lokale në qendër të qytetit dhe shumë pranë komisariatit. 25-vjeçari Markel Bushi është person me precedentë penalë dhe në kërkim nga policia që në vitin 2013, pasi akuzohet për grabitje me armë. Në vitin 2012 ai së bashku me një person tjetër kanë sul-



muar me armë disa vajza dhe i kanë grabitur. Për këtë ngjarje, ai u arrestua nga policia dhe mundi të arratiset disa muaj më vonë nga burgu dhe u dënua në mungesë nga gjykata me 9 vite burg. Policia ka tentuar edhe në 2013-ën ta arrestojë sërish, por ai i është kundërpërgjigjur me armë dhe ka mundur t'u shpëtojë prangave. Me precedentë penalë është edhe autori tjetër i dyshuar, 28-

vjeçari Vinçens Bushi. Ai ka qenë i arrestuar dhe dënua në 2017-ën për armëmbajtje pa leje, ndërsa është liruar nga drejtësia me shërbim prove. Fillimisht, ai u dënua me 6 vite burg dhe për shkak të gjykitimit të shkurtuar iu ul masa në 1/3 dhe 2 vitet që i mbeten iu lanë në shërbim prove. Bashkia Kurbin dërgoi në gjykatë një letër me arsyetimin se Pali ka sjellë të mirë në komunitet.

SHKURT

Applikimi i Arta Markut për kryeprokurorë mbërrin në KLP

TIRANË - Prokuroria e përgjithshme e përkohshme, Arta Marku kërkon të mbajë postin e saj me mandat kushtetues. Një ditë pasi dorëzoi emrin, aplikimi i Arta Markut për pozicionin e prokurorit të përgjithshëm ka mbërritur në zyrën e KLP-së brenda afatit të përcaktuar. Arta Marku me shpalljen e kandidatës do të sfidojë edhe tre kandidatët e tjerë, të cilët ditë më parë u regjistruan në garë për postin e kryeprokurorit. Deri tani janë në garë avokati Lulzim Alushaj, Fatjona Memçaj dhe Olsian Çela.

Shkon në gjendje të rëndë në spital, vdes i burgosuri

TEPELENË - Një i dënuar në burgun e Bëncës ka ndërruar dje jetë në spitalin e Tepelenës. Mësohet se Artur Zhupa është dërguar në gjendje të rëndë në spital, ku pak minuta më pas ka ndërruar jetë. Dyshohet se i burgosuri ka pësuar një atak kardial, por do jenë ekzaminimet e mëtejshme që do zbulojnë shkaku e vërtetë të vdekjes.

Gjykata për Krime të Rënda e lë në burg, 50-vjeçari: Më ballafaqoni me Bengasin

Grabitja spektakolare në aeroportin e Rinasit, Ragip Hajdini: Nuk jam unë "daja" që kërkoni

"Isha në varrimin e Muratajt. Ditën që ndodhi ngjarja kam qenë për drekë me disa miq"

TIRANË

Ragip Hajdini, një ngjashhtë të arrestuarit e megabrabitjes së ndodhur mesditën e 9 prillit, dhe u lla në burg pa afat nga Gjykata për Krimet e Rënda. Gjatë seancës gjyqësore për vendosjen e masës së sigurisë, 50-vjeçari nga Peja, i njohur me pseudonimin "daja" dhe që u arrestua pas dëshmisë së dhënë nga i penduari i drejtësisë Alkond Bengasi ka mohuar përfshirjen e tij në ngjarjen e bujshme. Mësohet se ai ka deklaruar se ka njohje me familjen e Admir Muratajt (mbeti i vrrarë me plumb në kokë gjatë grabitjes) dhe madje se kishte qenë edhe në varrimin. Pavarësisht këtij pretendimi, gjykatësi Bib Ndreca vendosi lënie në qeli të kosovarit. Gjithashtu, në seancën e zhvilluar me dyer të mbyllura, Hajdini ka sqaruar se ka alibi se në datën 9 prill, ditën e grabitjes ka qenë duke drekuar në Kavajë. 50-vjeçari ka sfiduar prokurorinë duke u shprehur se, nëse i gjendet një provë, ai është i gatshëm të rrijë në burg përjetë, ndërsa kërkoi ballafaqim me Alkond Bengasin. Shqiptari nga Kosova u zbulua nga dëshmia e Alkond Bengasit, i penduari që u bë bashkëpunëtor i drejtësisë duke sjellë zbrëthimin e plotë të grupit kriminal.



I arrestuari, Ragip Hajdini



Grabitja në Rinas

BALLAFAQIMI

Në seancën e zhvilluar me dyer të mbyllura, Hajdini ka sqaruar se ka alibi se në datën 9 prill, ditën e grabitjes ka qenë duke drekuar në Kavajë. 50-vjeçari ka sfiduar prokurorinë duke u shprehur se nëse i gjendet një provë, ai është i gatshëm të rrijë në burg përjetë, ndërsa kërkoi ballafaqim me Alkond Bengasin. Shqiptari nga Kosova u zbulua nga dëshmia e Alkond Bengasit, i penduari që u bë bashkëpunëtor i drejtësisë duke sjellë zbrëthimin e plotë të grupit kriminal.

ketë lidhje. Hajdini u arrestua të premtën që shkoi nga policia në zonën e Shkëmbit të Kavajës në një aksion të mbajtur sekret. Ai është identifikuar nga dëshmia e Alkond Bengasit, i cili e ka cilësuar si një nga personat që ka pasur dijeni për grabitjen dhe se "daja" ishte një person tullac nga Kosova, të cilin e kishte takuar disa herë me Admir Muratajn. Sipas dëshmisë së 34-vjeçarit Bengasi, ai e ka parë Hajdinin 10 ditë para ngjarjes në shoqërimin e Admir Muratajt dhe Klement Çalës, dy personat e dyshuar si organizatorë të grabitjes. Ragip Haj-

dini rezultoi me precedentë të ngjashëm penalë edhe në Kosovë, aty ku ka qenë i dyshuar për grabitjen e 25 kg ar nga Dhoma e Dëshmimeve në Policinë e Pejës, bashkë me 5 persona të tjerë. Përveç Hajdinit të arrestuar janë Oltion Veseli, Alkond Bengasi, Renaldo Sula, Elton Pikli dhe Saimir Cela. Gjatë grabitjes mbeti i vrrarë koka e grupit, Admir Muratajt nga Tropoja, i arratisur në 2013 nga burgu grek. Ndërsa, janë ende në kërkim shtetasit; Talo Çela, Klement Çala, Eldi Çala, Marenglen Hoxha, ish-punonjësi policie, Aleks Pepa dhe një tjetër.

DEKLARATA E "DAJËS"

"Kam njohje me familjen Muratajt. Isha në varrimin e Muratajt, kam njohje me vëllain e tij, Aleksandrin (ndodhet në burg). Por nuk jam unë 'daja' që kërkoni. Kam dëgjuar në media që flitej për një 'daja', por po të kisha lidhje, nuk rrija këtu. Mund të kisha ikur po të doja. Jam njohur me ngjarjen rreth një javë më parë, kur në skenë doli emri 'daja', por duke qenë se jam i pastër, nuk lëviza nga Shqipëria. Prej nëntorit nuk kam dalë nga territori i Shqipërisë.

dini rezultoi me precedentë të ngjashëm penalë edhe në Kosovë, aty ku ka qenë i dyshuar për grabitjen e 25 kg ar nga Dhoma e Dëshmimeve në Policinë e Pejës, bashkë me 5 persona të tjerë. Përveç Hajdinit të arrestuar janë Oltion Veseli, Alkond Bengasi, Renaldo Sula, Elton Pikli dhe Saimir Cela. Gjatë grabitjes mbeti i vrrarë koka e grupit, Admir Muratajt nga Tropoja, i arratisur në 2013 nga burgu grek. Ndërsa, janë ende në kërkim shtetasit; Talo Çela, Klement Çala, Eldi Çala, Marenglen Hoxha, ish-punonjësi policie, Aleks Pepa dhe një tjetër.

PRECEDENTI

Ragip Hajdini rezultoi me precedentë të ngjashëm penalë edhe në Kosovë, aty ku ka qenë i dyshuar për grabitjen e 25 kg ar nga Dhoma e Dëshmimeve në Policinë e Pejës, bashkë me 5 persona të tjerë. Përveç Hajdinit, të arrestuar janë Oltion Veseli, Alkond Bengasi, Renaldo Sula, Elton Pikli dhe Saimir Cela. Gjatë grabitjes mbeti i vrrarë koka e grupit, Admir Muratajt nga Tropoja, i arratisur në 2013 nga burgu grek.

Operacioni "Gracka", përfundon në pranga hajduti i garazheve

TIRANË - Policia e Tiranës ka arrestuar një 41-vjeçar të akuzuar për disa vjedhje. Operacioni i koduar "Gracka" është zhvilluar nga Komisarriati i Policisë nr.3, në kryeqytet. Blutë pas kallëzimit të bërë për tentativë vjedhjeje në garazhet e një pallati, kanë organizuar punën duke ngritur shërbime grackë. Si rezultat i këtyre shërbimeve u bë e mundur që rreth orës 04:30, të kapet në flagrancë shtetasi Edmond Piraniqi, banues në Kavajë, i dënau me parë për vjedhje. Nga veprimet e para hetimore, bazuar në mekanizmin, mënyrat, vendin dhe territorin ku kishin ndodhur vjedhjet, dyshohet se ky shtetas është autori për vjedhjen e sendeve dhe materialeve në disa garazhe dhe konkretisht: Më datë 11.03.2019, në rrugën "Hajredin Shtino", në garazhin e marrë me qira nga shtetasi A.G., dyshohet se ka vjedhur një kondicioner dhe zinxhirët e gomave të automjetit. Më datë 20.03.2019, në rrugën "Reshit Çollaku", në garazhin e shtetasi E.H., dyshohet se ka vjedhur vegla pune si dhe ka dëmtuar derën e mjetit. Vijnë puna për dokumentimin e ngjarjeve të tjera, duke u bazuar në pamjet filmike. Materialet në ngarkim të 41-vjeçarit kaluan prokurorisë për veprën penale "Vjedhja".

Gruaja: Mbjaj 3 fëmijë invalidë, bashkëshorti me probleme na dhunon

TIRANË - Mes skamjes dhe dhunës vazhdon çdo ditë jeta e një familje me 5 anëtarë në Fier. Pikërisht historia e kësaj familjeje u soll dhe në emisionin "Me zemër të hapur" në "News 24". Familja Troka jeton në Frakull të Fierit mes një varfërie të tejshkajshme. Mimoza është nëna e 3 fëmijëve, 2 vajzave dhe një djali, të tre të sëmurë dhe trajtohen me pension invaliditeti. Problemi më i madh që të katërt, ajo dhe tre fëmijët dhunohen në mënyrë sistematike nga kryefamiljari pasi ai vuan nga probleme të shëndetit mendor. Prej vitesh ai rrez-



BABAI I SEMURE DHUNON BARBARISHT FEMJET DHE GRUAN

ikon jetën e gruas dhe të fëmijëve, i godet me mjete të forta dhe kërkon t'i dëbojë nga banesa. Pas denoncimeve që

kanë bërë e kanë shtruar disa herë në spitalin psikiatrik të Vlorës, por pas ndërhyrjeve që bëjnë familjaret

e tij, vëllezërit dhe e ëma e kanë nxjerrë dhe e kanë rikthyer në banesë. Për shkak të dhunës dhe agresivitetit ai ka shkaktuar banesën, ka thyer dyer e dritare dhe shtëpia është bërë e pabanueshme. Mimoza kërkon ndihmë pasi nuk di si t'i mbrojë më prej bashkëshortit fëmijët e saj dhe bën apel që ata të mos bëhen viktimat e dhunës së të atit. "Është shtruar në psikiatri në Vlorë dhe e ka nxjerrë i vëllai. Ndonjë ditë do na vrasë, dua të më ndihmoni", tha gruaja në emision.

Raporti i Bankës së Shqipërisë për muajin mars


Kredia për ekonominë rritet ndjeshëm, bizneset preferojnë euron

Huaja e dhënë për eko-
nominë nga sistemi
bankar ka shënuar
gjallërim në muajt e parë
të këtij viti, e udhëhequr
nga kredia për bizneset
dhe për individët në lekë.
Sipas statistikave të pub-
likuara nga Banka e Sh-
qipërisë, stoku i kredisë
për ekonominë në fund të
muajit mars arriti në 547
miliardë lekë, duke shënu-
ar një rritje prej 1% në kra-
hasim me muajin e më-
parshëm. Në raport me
fundin e 2018-ës, kredia që
është dhënë nga bankat
për bizneset dhe individët

është rritur me 2.7%.
Megjithatë, me bazë vjetore
(mars 2019/mars 2018) tren-
di i kredidhënies mbetet në
rënie, me 0.23%, e ndikuar
edhe nga efekti që jep
nënçmimi i euros, teksa të
dhënat finale raportohen në
lekë. Në tre muajt e parë të
këtij viti, efektin kryesor në
gjallërimin e huadhënies e
ka dhënë kredia për bizneset

(korporatat e tjera jofinanci-
are) që u rrit me gati 3%
në raport me fundin e 2018-
ës. Euro është rikthyer në
monedhën e preferuar të bi-
zneseve, teksa të dhënat treg-
ojnë që kredia në valutë për
korporatat jofinanciare u
rrit me 3.7% në raport me
fundin e 2018-ës, përkundrejt
0.8% të monedhës vendëse.
Edhe për individët, rritja në

euro ishte 1.9% dhe në valutë
1% (me përjashtim të mar-
sit kur huaja në valutë për
individët erdhi në rënie). Si
rrjedhojë, pesha e kredisë në
valutë është rritur sërish,
duke arritur në 49.7% të to-
talisht në mars 2019, nga 49.4%
në të njëjtin muajt të një viti
më parë. Pikërisht një vit më
parë, Banka e Shqipërisë
nisi një fushatë për uljen e



nivelit të euroizimit në
ekonomi, por sërish euro vi-
jon të mbetet e preferuara e
bizneseve, por edhe e indi-
vidëve, teksa rritja e stokut
të huadhënies në tre muajt
e parë të vitit erdhi në 71%
nga valuta.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare: Primit bruto, mbi 3.9 miliardë lekë

Aksidentet, kompanitë paguajnë 12 milionë euro dëme

Pagesat rriten me 11.82%, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018-ës

Kompanitë e sigurim-
it kanë paguar 12 mil-
ionë euro dëme në pe-
riudhën janar-mars 2019.
Kjo shifër është 11.82 për-
qind më e lartë se e njëjta
periudhë e një viti më parë.
Statistikat zyrtare të Au-
toritetit të Mbikëqyrjes Fi-
nanciare për tregun e siguri-
meve në 3-mujorin e parë të
vitit tregojnë se të ardhurat
nga primit e shkruara bruto
të sigurimit për peri-
udhën janar-mars kapën
vlerën mbi 3.9 miliardë lekë,
ose 11.78% më shumë se në
periudhën janar-mars të
2018-ës.

RAPORTI

"Gjatë periudhës janar-
mars 2019, numri i kontrat-
ave të sigurimit të lidhura
arriti në 276,006, me një
rritje 5.68% krahasuar me
periudhën janar-mars 2018.
Tregu vazhdon të mbetet
sërish i orientuar te siguri-
rimet e Jo-Jetës, të cilat
sollën 91.78% të vëllimit të
përgjithshëm të primeve,
duke i lënë përkatësisht siguri-
rimet e Jetës me 7.25% dhe
veprimtarinë e risigurimit
me 0.97%. Parë nga kënd-
vështrimi i ndarjes së tregut
sipas llojit të sigurimit, i
detyrueshëm dhe vullnetar,
primit e shkruara bruto të
sigurimit vullnetar zënë
41.93% dhe primit e shkru-
ara bruto të sigurimit të
detyrueshëm zënë 58.07% të
totalit të tregut", vlerëson
AMF.

SIGURIMI I DETYRUESHËM

Ashtu siç ndodh tradicio-
nalisht, primit e sigurimit të
detyrueshëm motorik domi-
nojnë. Gjatë periudhës jan-
ar-mars 2019, këto prime ar-
ritën rreth 2.305 milionë
lekë, ose 4.29% më shumë se
në periudhën janar-mars
2018. "Produkti MTPL e
brendshme në periudhën jan-
ar-mars pati një rritje prej
3.44% të vullmit të primeve
të shkruara bruto. Kjo u sho-
qërua edhe me një rritje të
numrit të kontratave prej
3.71% krahasuar me peri-
udhën janar-mars 2018.
Produkti 'Karton Jeshil' në



periudhën janar-mars pati
një rritje prej 11.97% të volu-
mit të primeve të shkruara
bruto. Kjo u shoqërua nga
një rritje e numrit të kontr-
atave prej 55.03%, krahasu-
ar me periudhën janar-
mars 2018. Produkti 'Sigurim
Kufitar', në periudhën janar-
mars pati një ulje 18.00% të

volumit të primeve të shkru-
ara bruto krahasuar me pe-
riudhën janar-mars 2018.
Ndërsa numri i kontratave
u ulje me, 17.14%", raporton
AMF.
SIGURIMI VULLNETAR
Sipas Autoritetit të
Mbikëqyrjes Financiare,
primit e sigurimit vullnetar

Type of Insurance	Vlerat (në 000 lekë)		Ndryshimi (në %)
	2018	2019	18/17-1
Janar-Mars			
Dëmi mesatar			
MTPL e brendshme	204	208	1.79
Karton Jeshil	642	571	(11.04)
Kasko	121	97	(19.49)

gjatë periudhës janar-mars
2019 arritën rreth 1.664 mil-
ionë lekë, 24.12% më shumë
se në periudhën janar-mars
2018. Numri i kontratave të
sigurimit vullnetar u ul me
0.5%, krahasuar me peri-
udhën janar-mars 2018. "Siguri-
rimet vullnetare të Jo-Jetës
gjatë periudhës janar-mars
2019 patën rritje me 22.08%
kundrejt të njëjtës periudhë

të një viti më parë. Në porto-
folet e pronës, përgjegjësi-
ve, garancive të cilat gjatë pe-
riudhës janar-mars 2019 siguri-
ruan mbi 0.579 milionë lekë
të ardhura në total, vendin e
parë e zënë zjarri dhe dëm-
time të tjera në pronë me
rreth 76.30%, të pasuara nga
sigurimi i garancisë me
13.10% të totalit. Të ardhurat
nga sigurimet e aksidenteve

dhe shëndetit gjatë peri-
udhës janar-mars 2019 ar-
ritën në rreth 0.353 milionë
lekë, duke shënuar rritje prej
16.29% në krahasim me peri-
udhën janar-mars 2018.
Primit nga sigurimet e Jetës
gjatë periudhës janar-mars
2019 arritën rreth 0.288 mil-
ionë lekë, ose 19.62% më
shumë se në periudhën jan-
ar-mars", sqaron AMF.

Raporti i Institutit të Statistikave

Kriminaliteti u rrit, 120 vepra penale për 10 mijë banorë

Kriminaliteti në vitin
2018 shënoi rritje,
duke regjistruar një total
prej 34.468 veprash penale,
0.4% më shumë, krahasuar
me vitin 2017. Instituti i
Statistikave raportoi se
vitin e shkruar në raport me
popullsinë janë evidentuar
120 vepra penale për 10
mijë banorë, nga 119.4 që
ishin në vitin 2017. Lidhur
me klasifikimin e veprave
penale dhe ecurinë e tyre
në raport me vitin 2017, IN-
STAT raportoi se rritjen më
të madhe e kanë pasur ve-

prat penale e shkeljes së rreg-
ullave të qarkullimit rrugor
me një rritje 7.5% në raport
me 2017. Vjedhja nga ana
tjetër është një tjetër vepër
në rritje, me 4.1% më shumë
raste të regjistruara në vitin
2018, në raport me 2017-ën.
Më pas në rritje kanë qenë
vrasjet me dashje me 2%.
Pjesa tjetër e veprave penale
janë regjistruar në rënie, ku
krimet në fushën e drogës
kanë pasur 7.9% më pak raste
të regjistruara të veprave
penale sesa në 2017-ën. Mash-
trimet kanë rënë me 7.7%,

kurse krimet me dashje
kundër shëndetit 5.9%.
Lidhur me numrin e au-
torëve, shifrat zyrtare
raportojnë gjithashtu rritje.
"Në vitin 2018 janë regjistru-
ar 39.649 autorë për vepër
penale, 10,0% më shumë,
krahasuar me vitin 2017. Në
vitin 2018, meshkujt për-
bëjnë 92.9% të autorëve për
vepër penale", thuhet në pub-
likimin e INSTAT. "Në vitin
2018 janë regjistruar 19.101
persona të dëmtuar, 0.2% më
shumë, krahasuar me vitin
2017. Në vitin 2018 të dëmtu-



arit për krime kundër per-
sonit përbëjnë rreth 36,7% të
totalit të personave të dëm-
tuar. Në vitin 2018, në to-
talin e personave të dëmtuar
për krime kundër personit,
femrat përbëjnë 33,1% të të

dëmtuarve dhe përqindja
më e madhe e tyre vihet re
në krime seksuale, krime
kundër moralit, dinjitetit si
edhe krime kundër fëmijëve,
martesës dhe familjes", thu-
het në publikimin e INSTAT.

Drejtesja e "INAS Albania": Mungon marrëveshja bilaterale, pasojat mbi emigrantët

Cilat janë tri kriteret për të përfituar pension nga shteti italian

Aliaj: Duhet të bëhet riatdhesimi për të marrë pagesën

Voltiza Duro

Emigrantët shqiptarë që kanë jetuar e punuar në Itali mund të përfitojnë pension nga shteti fqinj, nëse plotësojnë kriteret e përcaktuara në legjislacionin Italian. Kushti i parë i përfitimit është moshë 66 vjeç e 7 muaj dhe kushti i dytë është minimumi 5 vite kontribute, në rast se emigranti ka filluar punë për herë të parë me kontribute të rregullta në Itali pas datës 1 janar 1996. Në këtë rast flitet për llojin e pensioneve si emigrant, i cili merr statusin e të riatdhesuarit me rikthimin e tij përfundimtar në vendin e origjinës, pra Shqipëri, duke lënë dhe anuluar kështu rezidencën e tij të mëparshme në Itali. Numri i emigrantëve të interesuar pranë zyrave të "Patronato Inas Cisl Albania", që arrijnë të marrin suport nga zyra e këtij patronati është gjithnjë e në rritje. Drejtuesja e INAS, Beskida Aliaj tregon rastin e dy shqiptarëve të rikthyer në Shqipëri pas emigrimit. "Janë dy histori sa të ngjashme edhe të ndryshme, por që në thelb ka dy kryefamiljarë që emigruan në Itali për arsye ekonomike. Njëri prej tyre, 71 vjeç, sot merr 306 euro pension nga Italia", - thotë Aliaj.



Beskida Aliaj

KRITERET

- Kushti i parë është moshë 66 vjeç e 7 muaj.
- Kushti i dytë është minimumi 5 vite kontribute, në rast se ka filluar punë për herë të parë me kontribute të rregullta në Itali pas datës 1 janar 1996.
- Kushti i tretë, emigranti duhet të marrë statusin e të riatdhesuarit me rikthimin e tij përfundimtar në vendin e origjinës, pra Shqipëri, duke lënë dhe anuluar kështu rezidencën e tij të mëparshme në Itali.

SHTETET QË KANË FIRMOSUR MARRËVESHJEN BILATERALE:

- Belgjika
- Luksemburgu
- Turqia
- Gjermania
- Çekia
- Rumania
- Hungaria
- Austria
- Kanadaja
- Hungaria
- Maqedonia

Problem mbetet Italia dhe Greqia, dy vendet që kanë edhe numrin më të lartë të emigrantëve shqiptarë, por që marrëveshjet me këto shtete ende nuk janë konkluduar, megjithatë mbeten në pritje të një dritë jeshile nga këto vende. Problematika pa diskutim është e madhe, këtë e shikojmë edhe vetë. Problematika kryesore është mungesa e një marrëveshjeje bilaterale midis shtetit shqiptar dhe shtetit italian për një reciproke të periudhave kontributive të punuara në Shqipëri dhe në Itali, pra bashkimin e këtyre periudhave. Ndërkohë që Italia ka marrëveshje me shumë shtete të BE-së dhe shtete të tjera, me Shqipërinë nuk është arritur akoma të lidhet një marrëveshje e tillë. "Së pari, nuk ka një reciprocitet, ndërkohë që emigracioni shqiptar në Itali është në numër shumë të madh, punonjësit italianë që janë këtu në Shqipëri dhe që trajtohen sipas ligjit shqiptar janë në numër shumë të vogël. Së dyti, Italia dhe Greqia po kalojnë periudha të vështira ekonomike. Ne ndjekim hap pas hapi zhvillimet ekonomike në Itali dhe rezultoni se kohët e fundit ekonomia italiane ka qenë në recension dhe vazhdon të jetë e tillë. Po në këto kushte është edhe Greqia. Mund të themi që si rezultat i krizës ekonomike është rritur shumë edhe papunësia, që influencën direkt tek emi-

grantët tanë. Kriza ekonomike dhe kosto që kanë këto vende për të përballuar pensionet e emigrantëve duket se janë ndër shkaqet primare që e kanë shtyrë firmosjen e këtyre marrëveshjeve. Edhe në syrin e specialistëve të pensioneve, bashkimi i viteve të punës i emigrantëve shqiptarë për të

përfituar një pension pleqërie mbetet një problem serioz për t'u zgjidhur nga shteti shqiptar", - bën me dije drejtuesja e INAS Albania. Kjo e fundit shton se qeveria shqiptare ka mbyllur një sërë marrëveshjesh të tilla me vende si Belgjika, Turqia, Rumania apo Luksemburgu, ndërsa është në negociata edhe me Italinë dhe Greqinë, finalizimi i të cilave do të ishte zgjidhja e "jetës" për shumë familje shqiptare, të cilat do mund të merrnin pension për vitet që kanë punuar si në Shqipëri dhe në Greqi apo Itali, pa qenë e nevojshme që të riatdhesohen. Numri i shteteve me të cilat Shqipëria ka rënë dakord për të njohur dhe bashkuar pensionet e emigrantëve, apo vitet kontributive është rritur ndjeshëm. E firmosur tashmë me 11 shtete, marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të pensioneve u jep mundësi mijëra emigrantëve shqiptarë që

kanë ndarë vitet e punës mes Shqipërisë dhe një shteti tjetër të mos humbasin kontributet e derdhura për asnjë ditë pune. Respektivisht shtetet që e kanë firmosur këtë marrëveshje janë Belgjika e Luksemburgu. Ndërkohë janë nënshkruar marrëveshjet me Turqinë, Gjermaninë, Austrinë, Kanadanë, Hungarinë dhe Maqedoninë. Kanë nisur negociatat edhe me Italinë.

PAGESA PËR PENSIONIN

"Po të marrim në mënyrë hipotetike, një emigrant shqiptar që ka punuar në Itali 19 vjet dhe në Shqipëri 14 vjet në Itali nuk përfiton pension se nuk ka plotësuar 20 vjet për t'u futur në kushte pensioni. Në Shqipëri nuk përfiton pension, sepse ka 14 vjet dhe nuk ka plotësuar 15 vite për të paktën pension të pjesshëm në Shqipëri. Pra, 33 vite djersë e tij nuk reflektohet në të ardhurat që mund të ketë. Kështu që në rast të bashkimit të periudhave kontributive; në rast të një marrëveshjeje bilaterale, krijohet tërësisht mundësia për të marrë përfitime nga të dyja shtetet", - thekson Aliaj. Kjo e fundit bën me dije se nëse një person që ka punuar 10 vite në Shqipëri, që nuk përfiton aktualisht nga ligji shqiptar dhe 10 vite në Itali që aktualisht nuk përfiton nga ligji italian, po t'i bashkohen këto vite, atëherë ky plotëson vjetërsinë kontributive, pra 10 vite në Itali, plotëson edhe 10 vite në Shqipëri dhe i bashkohen këto dy periudha. Këtë ka qëllim edhe marrëveshja bilaterale, për njohjen dhe bashkimin e dy periudhave kontributive dhe pastaj në marrëveshje çdo shtet, secili shtet do të japë kontributin e

Siguria e punonjësve në punë

Denaj: Bashkëpunim shtet-punëdhënës-punëmarrës

Siguria në punë, Respektimi i ligjit në deklarin punëmarrësve si dhe një bashkëpunim mes aktorëve shtet-punëdhënës-punëmarrës do të sigurojë zhvillimin e një shoqërie, sipër-marrjeje dhe ekonomitë të qëndrueshme. Këtë fakt bëri me dije Ministra e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, gjatë mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Punës.



Gjatë fjalës së saj, ministrja Denaj i kushtoi një vëmendje të veçantë çështjes së sigurisë në punë dhe u shpreh se krijimi i kushteve të favorshme për sigurinë e punonjësve është domosdoshmëri për të pasur një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. "Shëndeti dhe siguria në punë e punonjësve mbetet një detyrim për çdo kompani private e publike dhe në vëmendjen tonë, veçanërisht të Inspektoratit të Punës, do të mbetet përmirësimi i kushteve dhe standardeve që garantojnë sigurinë maksimale për punonjësit", u shpreh Denaj. "Gjatë vitit 2019 - theksoi ministrja Denaj - vëmendja do të jetë të përmirësimi i marrëdhënies me biznesin dhe ndërgjegjësimi për vëmendje ndaj sigurisë së shëndetit të punëmarrësit dhe kushteve të punës, sigurimin e transparencës në vendimmarrje të rritjen profesionale të inspektorëve". Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, z. Eduard Shali; ministri i Turizmit dhe Mjedisit, z. Blendi Klosi; zv.ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Bardhylka Kospiri; zv.ministri i Infrastrukturrës dhe Energjisë, z. Ilir Bejtja etj.

vet. Pra, Shqipëria do të japë kontributin për 10 vitet që qytetari ka punuar në Shqipëri dhe Italia do të japë kontributin e saj për të njëjtin individ që ka punuar edhe në këtë shtet. Pensions do të llogaritet në bazë të të gjithë pagave dhe kontributeve që qytetari ka derdhur për një punë të caktuar.

PATRONATI INAS

Patronati INAS lindi si nevojë e domosdoshme për mbrojtjen e sindikatave dhe sindikalistëve, për të mbrojtur punonjësit para padrejtësive që mund t'i bëheshin nga administrata shtetërore qoftë për probleme të sigurimeve shoqërore, qoftë për probleme të tjera sociale. Ajo ka në Itali rreth 700 zyra, po

ashtu ka edhe përfaqësi në vende të tjera, ku ka emigracion italian. Me këto vende janë lidhur marrëveshje bilaterale, ku emigrantët italianë pa qenë nevoja të vijnë në Itali bëjnë bashkimin e viteve kontributive dhe përfitojnë pension në vendet ku punojnë dhe jetojnë. Dhe duke qenë se në Itali është një emigracion shumë i lartë shqiptar, ku janë me dokumente të rregullta rreth 500 mijë, atëherë u pa e nevojshme që në mbështetje të këtij emigracioni, duke parë problematikat e shumta që ka, të ngrihet një përfaqësi e INAS-it, por edhe të punëdhënësve dhe punonjësve italianë që punojnë këtu në Shqipëri.

STATUSI I MINATORIT PROTESTA

Voltiza Duro

Në Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve, punonjësit e nëntokës kanë zgjedhur të protestojnë për të drejtat e tyre dhe miratimin e statusit të minatorit. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare, ish-punonjësi i nëntokës, Mark Gjergji, tregon të gjitha arsyet e protestave të vazhdueshme, duke theksuar se nuk do të heqin dorë deri në realizimin e kërkesave të tyre. Ai shton se për vite me radhë qeveria vetëm i ka premtuar dhe e ka mashtruar këtë kategori, duke i lënë në mëshirë të fatit. Marku thekson se kërkojnë që të gjithë minatorët që kanë punuar 10.5 vite në nëntokë të marrin pagesën minimale prej 260 mijë lekësh të vjetra si dhe 140 për qind, pra në total 364 mijë lekë të vjetra. Gjithashtu, kush ka mbi 10.5 vite në minierë, për çdo vit më shumë ai do të marrë 2 për qind shtesë mbi këtë pagë. Një tjetër kërkesë e tyre ndaj qeverisë shqiptare është edhe trajtimi nga shteti i minatorëve që vuajnë nga sëmundjet profesionale. Kjo presupozon që shpenzimet e trajtimit duhet të përballohen nga shteti dhe firmat ku minatorët punojnë, ndërsa ilaçet të rimbursohen po nga shteti.

Nesër (sot) në Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve, minatorët kanë vendosur të protestojnë. Pse do të protestoni?

Sot, në Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve, ne bashkëvuajtësit e frontit më të vështirë, të nëntokës kemi vendosur të organizojmë një protestë. Por kjo protestë nuk do të jetë si ato që kemi bërë deri tani. Minatorët në vitet e tranzicionit kanë bërë plot 200 protesta, por e sotmja do të jetë e fuqishme, pasi ne jemi më të vendosur se kurrë për të ngritur zërin e për të luftuar për të drejtat e mohuara.

Deri më tani, a nuk kemi mundur të arrinim një marrëveshje me ministrinë përveçjese dhe qeverinë?

Ne jemi nismëtarët që kemi kërkuar të fitojmë ato pak të drejta që i meritojmë. Parimisht është rënë dakord me ministrinë sipas grupit të punës të ngritur që në 15 mars të 2018. Ky grup kishte përfaqësues nga Ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturas si dhe përfaqësues të minatorëve, përkatësisht Nikollë Gjoka, Ali Çaushi dhe Ded Marku. Sipas përfaqësuesve të nëntokës, gjatë bisedimeve u ra dakord për miratimin e statusit, por mesa duket qeveria nuk ka

"Sindikatat nuk kanë bërë asgjë për ne. Ministrinë nuk arrijnë të negociojnë"

Minatorët në protestë, Gjergji: Qeveria na ka mashtruar për vite me radhë

"Të palëkundur, deri në plotësimin e kërkesave tona"



Foto ilustruese

PSE PROTESTOHET

Sot, në Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve, ne bashkëvuajtësit e frontit më të vështirë, të nëntokës kemi vendosur të organizojmë një protestë. Por kjo protestë nuk do të jetë si ato që kemi bërë deri tani. Minatorët në vitet e tranzicionit kanë bërë plot 200 protesta, por e sotmja do të jetë e fuqishme, pasi ne jemi më të vendosur se kurrë për të ngritur zërin e për të luftuar për të drejtat e mohuara.

KËRKESAT E MINATORËVE

1. Miratim i statusit të minatorit
2. Rritje e pensioneve të këtyre punonjësve
3. Luftë ndaj informalitetit në punë
4. Siguri dhe kushte më të mira pune
5. Rritje e pagës minimale

vullnetin e duhur që të thërrasë ministrinë si atë të Infrastrukturas, edhe atë të Financave dhe përfaqësues të minatorëve nga sindikatat. Dua të theksoj se këto të fundit vetëm emrin kanë të tillë, pasi nuk e kanë bërë punën e tyre siç duhet.

A mund të na tregoni më specifikisht se cilat janë kërkesat e minatorëve?

Kërkojmë që qeveria të

bashkëpunojë me minatorët dhe të na plotësojë kërkesat tona. Ndër pikat më kryesore që kërkojmë domosdoshmërisht të realizohen janë: të gjithë minatorët që kanë punuar 10.5 vite në nëntokë të marrin pagesën minimale prej 260 mijë lekësh të vjetra si dhe 140 për qind, pra në total 364 mijë lekë të vjetra. Gjithashtu, kush ka mbi 10.5 vite në minierë, për çdo vit

Ne jemi nismëtarët që kemi kërkuar të fitojmë ato pak të drejta që i meritojmë. Parimisht është rënë dakord me ministrinë sipas grupit të punës të ngritur që në 15 mars të 2018. Ky grup kishte përfaqësues nga Ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturas si dhe përfaqësues të minatorëve, përkatësisht Nikollë Gjoka, Ali Çaushi dhe Ded Marku.

më shumë ai do të marrë 2 për qind shtesë mbi këtë pagë.

Cila është kërkesa juaj lidhur me minatorët e prekur nga sëmundjet profesionale?

Dua të theksoj se një pikë tjetër në listën e kërkesave tona është trajtimi i minatorëve që vuajnë nga sëmundjet profesionale. Shpenzimet e trajtimit duhet të përballohen nga shteti dhe firmat ku minatorët punojnë, ndërsa ilaçet do të rimbursohen po nga shteti.

Cila është thirrja juaj ndaj punonjësve të nëntokës?

KËRKESAT E MINATORËVE

Kërkojmë që qeveria të bashkëpunojë me minatorët dhe të na plotësojë kërkesat tona. Ndër pikat më kryesore që kërkojmë domosdoshmërisht të realizohen janë: të gjithë minatorët që kanë punuar 10.5 vite në nëntokë të marrin pagesën minimale prej 260 mijë lekësh të vjetra si dhe 140 për qind, pra në total 364 mijë lekë të vjetra.

THIRRJA NDAJ MINATORËVE

U bëj thirrje të gjithë minatorëve që të na bashkohen nesër (sot) në protestë dhe të jenë të vendosur si asnjëherë tjetër. Sa më të shumtë të jemi në numër, aq më mirë, pasi do t'i japim fund këtij aksioni të stërzgatur dhe do arrijmë patjetër në fitore.

U bëj thirrje të gjithë minatorëve që të na bashkohen nesër (sot) në protestë dhe të jenë të vendosur si asnjëherë tjetër. Sa më të shumtë të jemi në numër, aq më mirë, pasi do t'i japim fund këtij aksioni të stërzgatur dhe do arrijmë patjetër në fitore. Duhet të qëndrojmë të bashkuar dhe të mos përçahemi nga pseudosindikatat. Nëse sindikatat do të funksiononin siç duhet dhe do të mbrojnë minatorët, ne nuk do të ishim këtu sot.

Në qoftë se kërkesat tuaja nuk do të plotësohen, a do të ketë përshkallëzim të protestës?

Nëse kërkesat tona nuk do të plotësohen e nëse nuk arrijmë një fitore të plotë, do të protestojmë të palëkundur, edhe pse shumica nga ne janë të sëmurë. Deri më tani shteti është tallur me ne, na ka premtuar për mirësimin e situatës, por çdo gjë ka rezultuar një mashtrim i madh.

Si paraqitet gjendja e punonjësve të nëntokës sot?

Jo pak minatorë lëngojnë në krevat me ilaçe, që s'kanë as mundësi ekonomike për t'i blerë. Ndërkohë që pensionet që marrin ky kategori janë të pamjaftueshme për të përballuar jetesën. Mesa kemi informacion, shumë prej shokëve që kemi punuar bashkë janë larguar në kurbet e kanë marrë rrugët e emigrimit për një jetë më të mirë, e me pag-

esa më të larta se këto pensione qesharake që na jep shteti shqiptar. Por jo pak minatorë kanë vdekur pa e gëzuar atë pension të ulët, për shkak të sëmundjeve të ndryshme që i ka falur kjo punë në nëntokë. Tani kemi ngulur ne, ish-minatorët që kërkojmë me ngulim miratimin e statusit dhe s'do të ketë kthim mbrapa këtë herë. Jemi të varfër, të braktisur dhe të zhgënjyer nga ky shtet.

Ju personalisht, si jeni trajtuar nga shteti pas daljes së papunë për shkak të mbylljes së minierës? A jeni i kënaqur me pensionin që merrni?

Ne nuk kemi shtet këtu në Shqipëri, asnjë gjë s'po bëhet për ne, pavarësisht se i kemi dhënë kaq shumë e madje shumë prej nesh edhe jetën. Që prej vitit 1997 dola në kurbet në këmbë nga malet, e kam nxjerrë bukën e familjes me 4 vite punë aty. Nëse do e lija veten në dorë të politikave të shtetit, do isha kalbur në barakë. Tashmë jetoj në Thumanë, në Dukagjin të Krutjes së bashku me gruan e tre djemtë. Shteti shqiptar po më jep një pension qesharak prej 150 mijë lekësh të vjetra në muaj. Arrij të marr një thes miell, një bombol gazi e kaq për gjithë muajin. Jashtë Shqipërisë minatorët respektohen e paguhen, kurse ne s'kemi bukë të hamë.

TEATRI

DALIN FOTOT

Natën e së premtes së madhe, kur hiqeshin germat e emrit të teatrit

Fatmira Nikollë

Mëngjesin e së Premtes së Madhe para Pashkëve, godina e Teatrit Kombëtar u gdhi pa shkronjat identifikuese në fasadën e saj. 14 shkronjat e emrit TEATRI KOMBËTAR u hoqën natën, në mënyrë të fshehtë dhe të nesërmen, kur kalimtarët shpejtonin këmbët në shëtitoren mes Ministrisë së Brendshme dhe godinave të dy teatrove kombëtarë nuk e vunë re se mbi fasadë kish mbetur tashmë vetëm hija e 14 germave që për dekada të tëra identifikonin skenën më të madhe të artit në vend. Në një qytet ku edhe plehrat hiqen ditën duke krijuar trafik, dikush kishte menduar për një operacion me "diversantë" që dilnin natën nëpër qytet dhe "shpërndanin trakte".

Sa do të rrekesh të jesh objektiv dhe i ftohtë dhe ta gjykojë çështjen e teatrit thjesht si një debat (normal) mes një grupi që do ta mbrojë atë godinë dhe një grupi që do ta shembë, është pothuaj pamundur ta ruash neutralitetin (a qoftë edhe seriozitetin) kur mëson se germat janë hequr natën duke dhurë e premtja e madhe e Pashkëve! Veprimi është kaq qesharëk dhe në kufijtë e absurdit. Ndërsa besimtarët bëheshin gati për të kremtuar festën e Pashkës dhe kabanat e katedrales jehonin mbi qytet, një mëngjes herët, kur dielli ende nuk i ka ndriçuar rrugët e kopshtit shkëmbor të Europës Juglindore, dikush heq 14 shkronja mbi një mur dhe sjell një tjetër rrëfë nga Zullullandi. E premtja e madhe nuk mund të ishte më e zezë. Diku ishte Juda, e diku tjetër Baraba. Ponci Pilat i kishet larë duart dhe turma e judenjve e kishte shpallur një fajtor.

Prej më shumë se 365 ditësh artistë e aktivistë takohen në një protestë të përnatshme para teatrove në mbrojtje të tyre, shkronjat hiqen pa dalë drita. Ne e mundim fantazinë me historitë e së përditshmes.

Godina që prej një viti është jofunkionale sepse teatri është zhvendosur prej aty për të Turbina, e me heqjen e shkronjave duket se 'humb' me emrin edhe një prej shenjimeve të fundit që e lidh me artin. Thënë kjo, artistët që prej një viti kur u prezantua nga qeveria ideja e shembjes së tij për të ndërtaur një të ri po protestojnë për ta mbrojtur e kanë interpretuar heqjen e shkronjave si hap drejt shembjes.

REGIMI

Kur të premtën u kuptua që sh-

Aleanca për Mbrojtjen gozhdon me imazh bashkinë: Kur akuzuam Veliqajn, nuk spekuuam



Punëtorët e bashkisë duke hequr shkronjat e Teatrit Kombëtar

kronjat ishin hequr, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit pasi akuzoi shtetin i kërkoi publikisht Ministrisë së Kulturës të distancohej nga ky veprim dhe akuzoi kryeministrin dhe kreun e bashkisë për veprimin. "Fasada e Teatrit Kombëtar u zgjua e dhunuar, e zhveshur nga shkronjat identifikuese të saj. Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit e dënon këtë akt të ulët dhe kërkon nga Ministria e Kulturës të mbajë urgjentisht dhe publikisht qëndrimin për sa ka ndodhur dhe të kujdeset që shkronjat të rivendosen aty ku ishin", shkroi të premtën Aleanca. Ministria nuk pati asnjë reagim zyrtar dhe të shtunën, Aleanca bëri një padi në prokurori duke u betuar se do t'i vërë prapë shkronjat.

Dje, një foto e realizuar gjatë momentit që hiqeshin shkronjat nxjerr në pah një makinë tip kamionçine, nga ato që përdoren për të varur zbulimet e fundvitetit a ditës së verës, tregon disa punonjës që heqin germat në një natë të zezë pis.

"Punonjësit e bashkisë erdhën në orën 04:30 të mëngjesit dhe i hoqën"



në profilin e saj Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit.

Ky veprim është kryer në kohën kur protesta e aktivistëve për mbrojtjen e godinës së Teatrit Kombëtar vazhdon. Ndërkohë, qeveria i qëndron vendimit të saj ta prishur këtë godinë. Veprimi nxiti reagime të shumta nga grupet e artistëve, por asnjë reagim nga institucionet përgjegjëse shtetërore.

"Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit e ka dënuar këtë akt duke e konsideruar si të ulët dhe kërkon nga Ministria e Kulturës të mbajë qëndrim për ç'ka ka ndodhur si dhe të rivendosë shkronjat. Sipas Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, nëse kjo nuk do të ndodhë, vetë Aleanca do të ndërmarrë një aksion privat për rivendosjen e tyre. Regjisori dhe anëtari i Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit Robert Budina ditë më parë se jo është një goditje në simbolikë për të thënë që nuk do të ketë Teatër Kombëtar, nuk do të ketë kulturë, për t'i hequr atyre identitetin. Dhe kjo bëhet natën skuthërisht nga njerëz që nuk e kanë identitetin dhe emrin e tyre. Ndaj Teatrit e ka betejën të fituar me anonime që

janë shumë të vegjël para tij për ta shembur".

Sipas Kastriot Çipit, në bazë të ligjit special për "Rindërtimin e Teatrit Kombëtar", Ministria e Kulturës dhe Bashkia Tiranë duhet të bashkëpunojnë për të shpallim urban të zonës" dhe krijimin e komisionit negociator për vlerësimin e tyre. "Por këto veprime duhet të bazohen në një Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende, megjithëse afati ligjor ka kaluar qysh më 13 dhjetor 2018. Atëherë pse u hoq emri i Teatrit Kombëtar nga fasada? A nuk është kjo, në rastin më të mirë, komprometim i garës? Ligji special thotë se i takon komisionit negociator të vendosë për këtë ndërtesë. Kjo do të thotë se komisioni ka të drejtë edhe t'i refuzojë të gjitha projektet e paraqitur në garë dhe, në këtë rast, Teatrit Kombëtar nuk ka arsye të shembet. Me këtë veprim, shteti tregon sa seriozisht e merr garën dhe ligjin, institucionet e drejtësisë dhe vetë nocionin e drejtësisë", thekson Kastriot Çipi, ish-drejtor i Teatrit të Komedisë dhe pjesë e Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit.

VIP

Suplement
Pages

Emërkurë 1 Maj 2019

GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj

"BULEVARDI POLITIK"

- Ngjashmëria, Jozefina Topalli prezanton dy mbesat e saj
- Princ William dhe Kate Middleton festojnë 8 vjet martesë
- Ish-deputeti i futet shahut, barazon me kampionin e Shqipërisë
- Ia dha administrata e kohës, Musolinin i hiqet qytetaria e nderit


Fero dhe Arbenita e bëjnë lidhjen serioze? Ja hapi tjetër i reperit



Kjo s'pritej, ish-banorja e "Big Brother" i futet muzikës



Rrëfihet shqiptarja: Italia më ofroi atë që Shqipëria e atyre viteve s'mund të ma ofronte



I STAND WITH REFUGEES

Kandidate për zgjedhjet në Itali, Sonila Alushi: Ditët e para atje ishin traumatike

"Paragjykimi është një nga problemet më të mëdha që kemi si shoqëri"

Grëfhet shqiptarja: Italia më ofroi atë që Shqipëria e atyre viteve s'mund të ma ofronte

Kandidate për zgjedhjet në Itali, Sonila Alushi: Ditët e para atje ishin traumatike, lava me lot rrugët e aeroportit

"Paragjykimi është një nga problemet më të mëdha që kemi si shoqëri"

Nga Alma Nikolli

Sonila Alushi, është vajza çame që kandidon për këshillin bashkiak të Bergamos, në listën Gori. Është femija i parë në familje dhe siç rrëfen ajo, të gjithë dëshironin të ishte djalë, por Sonila është një nga vajzat me të cilat krenohet jo vetëm familja, por edhe Shqipëria. Sonila tregon për "Gazeta Shqiptare": "Ditët e para në Itali kanë qenë traumatike. Fluturimin e parë e kisha për në aeroportin Fiumicino të Romës. Ishte fund gushti i vitit 1998, isha vetëm 19 vjeç. Polici i kufirit, pasi më pyeste pa ndaluar dhe vuri re bezdinë që ndjeva nga ai pyetësor me tone arrogante, më shoqëroi në një qendër policore të aeroportit për verifikime. Aty m'u desh të pres për orë të tëra pa mundur as t'i telefonoj prindërve për t'u thënë që fluturimi kish shkuar mirë. Verifikimet shkuan aq gjatë sa humba avionin tjetër për në veri. Frika se do më duhet të kaloja natën në aeroport dhe mbaje jo vetëm një natë, më bëri të laja me lot rrugët e aeroportit. Humba valixhet, ato tre gjëra që kisha, humba dhe kurajën për momentin. Fati desh që u gjend një vend atë natë në një avion tjetër dhe e ndihmuar nga udhëtarë të rastit, arrita të shkoj në shtëpinë e të afërmeve të mi pas një dite të tmerrshme! Vetëm më vonë kuptova që atë ditë kisha paguar çmimin e paragjykimit që ishte krijuar në Itali, për vajzat shqiptare, si pasojë e prostitucionit. Ditët më pas mezi dola nga shtëpia, më duhet të jepja proviminin e gjuhës italiane në Universitetin e Bergamos ku isha regjistruar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe Letërsisë. Fillimi që shumë i vështirë në një qytet të vogël, që asokohe ishte mësuar pak me të huajt. Por pas disa vitesh "luftë" për gjithçka, nga puna e deri tek catia, vendosa që do reagoja ndryshe: I premtova vetes që askush nuk do arrinte më të më bënte të ndiheshja jo si në shtëpinë time. Ndjeja nevojën të hidhja rrënjë, të mos ndjehesha e huaj. Që nga ajo ditë u përqendrova tek gjithçka pozitive që më ndodhte e tek të gjithë njerëzit e mirë që takoja. Kështu vazhdoj dhe sot. Nuk është naivitet, është zgjedhje e ndërgjegjshme për të përballuar çdo vështirësi me energji pozitive."

A mendove ndonjëherë të ktheshes pas?

Ka patur një moment që e kam menduar kthimin, malli bënte të vetën, por Shqipëria vazhdoante të vuante një mentalitet të fortë patriarkal dhe situata ekonomike, e sociale ishte ende shumë e vështirë. Pasi u martova e sidomos pasi erdhën fëmijët, çdo tundim për kthim avulloi. I u kuptova që tashmë kisha vënë vërtetë rrënjë në Bergamo. Por me Shqipërinë nuk i zbeha kurrë lidhjet. Fëmijët flasin shqip,



vijnë në Shqipëri me shumë dëshirë dhe e duan shumë origjinën dhe traditat tona.

Në mesin e vështirësive të fillimit, Italia i ofroi Sonilës gjënë më të rëndësishme për një grua shqiptare të atyre viteve: lirinë.

Italia më ofroi atë që Shqipëria e atyre viteve nuk mund të më ofronte: lirinë e të qenit grua e lirë në radhë të parë. Italia më ofroi mundësinë e një pune të paguar më mirë duke bërë të mundur edhe ndihmën për prindërit e mi. Italia, emigrimi, më dha mundësinë të kalës karakterin dhe të kem mundësi të marr nga kjo kulturë disa cilësi që i karakterizojnë si popull: ndjeshmërinë e madhe ndaj të bukurës, përlësinë si vlerë e jo si turp, xhentilësinë si pjesë e një personaliteti të fortë e jo të dobët.

Punët e para të Sonilës: Kamariere, lavapjatesë, pastruese dhe shitëse

Sonila e mori rrugën e emigracionit për të studiuar, por paralelisht me universitetin iu desh edhe të punonte. Punët e para nuk ishin ato të ëndrrave. Për disa vite punoi si kamariere, lavapjatesë, pastruese apo shitëse, eksperiencia që i vlerëson jo pak në zhvillimin e saj të mëvonshëm. "Punët e para që kam bërë për shumë vite kanë qenë kamariere, lavapjatesë, pastruese dhe shitëse. Nga Tirana vija nga një eksperiencë e shkurtër në gazetari për një revistë drejtuar adoloshentëve, e cila quhej TEST. Këto punë ishin tej mase larg ëndrrave të mia, por më shërbyen shumë si eksperiencia. Pasi u njoha me tim shoq, e pasi kishim bërë një eksperiencë në pastrimin e hyrjeve të pallateve, vendosëm të hapnim një firmë pastrimesh. Sot firmat që kemi janë tre të cilat merren dhe me ndërtim. Punëtorët janë më së shumti shqiptarë dhe them me krenari që punojmë shumë mirë së bashku,



kemi ditur të bëjmë skuadër. Dhe kjo nuk është vetëm meritë e jona, por dhe e mbi të gjitha e tyre."

A e ndjen Italianë si atdheun tënd?

"Po, pas 21 vitesh mund të them që edhe Italia është Mëmëdheu im. Jam vajzë e saj e adoptuar, por vajzë edhe e saj, jo vetëm e Shqipërisë. Më e rëndësishmja është se Italia, Bergamo, është mëmëdheu i fëmijëve të mi. Nuk kam se si të mos e dua e të mos i jem mirënjohëse."

Çamëria, themeli i karakterit të Sonilës

Sonila "ushqehet" me tre shije. Bukë, bakllava dhe ullinj. Ajo na e shpjegon përmes vargjeve qenien e saj sa çame shqiptare, e sa italiane. Ajo është rritur me mallin për tokën e saj, Çamërinë. Edhe pse e dënuar për t'i qëndruar larg, Sonila njeh edhe gurët e rrugicave të vendit ku kanë lindur e janë rritur katër gjyshërit e saj. "Çamëria ka qenë dhe është për mua themeli i karakterit tim: jam rritur me tregimet e gjyshes që më ushqyen dashurinë për një tokë e cila mund dhe duhet të kish qenë edhe toka ime. Njoh edhe gurët e rrugicave ku kanë lindur e janë rritur të katër gjyshërit e mi; njoh dialektin e ëmbël, poezitë e kënduara dasmave, bëmat e stërgjyshit, kalin e tij të bardhë, karakterin e tij të fortë. E njoh atë tokë dhe ato të shpëti nëpërmjet zërit të saj kur pinte kafënë e hidhur e pastaj, me një gjest të shpejtë, e kthente filxhanin mbi pjatën e vogël. Çamëria është pjesë e imja dhe fakti që deri diku arrita të çoj përpara amanetin e gjyshes, ndonçim i padrejtësisë që i është bërë popullit tonë dhe ruajtja e traditave tona, është krenaria ime më e madhe. Gjyshen në fjalë e kam ende gjallë dhe asnjë arritje imja e shkuar apo e ardhme nuk do të krahasohet me këtë."

Si çame, a je ndjerë e huaj në atdheun tënd, Shqipërinë?

Në radhë të parë unë preferoj të flas për vendin ku kam lindur e ku jam rritur si mëmëdheu, toka, nëna, se kështu arrij edhe ta dua më shumë. Nuk jam e ndjerë e huaj, sepse u rrita në një familje të fortë, e cila diti ta luftojë paragjykimin. Por shpesh ndjehesha ndryshe nga të tjerët. Për shembull fakti që më thërrisnin shpesh "Sonila çomja", apo fakti që nuk arrija të flisja totalisht me dialektin tiranas, bënte që të isha apo konsideroheja disi ndryshe nga fëmijët e tjerë.

A mund të fitojë Sonila, një shqiptare, në zgjedhjet lokale në Itali?

Ajo mendon se po. "Patjetër që po, ne jemi komuniteti më i integruar dhe kjo gjë ka sjellë edhe pjesëmarrjen në politikë, sepse mbështetja dhe besimi tek ne është rritur ndjeshëm. Normalisht mundësitë do kishin qenë më të mëdha nëse do të kishim qenë më të organizuar si komunitet, por dihet, kjo është pika jonë e dobët që më shumë se çdo gjë tjetër na pengon në shumë raste. E them këtë sepse nga radhët tona janë shtuar shqiptarët me shtëpisi italiane duke u bërë kështu edhe fuqi politike. Pra është më se e ditur që ftohemi për kandidatura nga partiitë kryesore, pikërisht për të afruar drejt votës më së shumti bashkatdhetarët tanë. E nëse ne do të ishim organizuar më mirë për të mbështetur ata kandidatë shqiptare me më shumë kompetenca dhe eksperiencë, mundësitë për fitore do të kishin qenë më të larta."

Cila është lufta jote e përditshme për çështjet e emigracionit?

"Lufta ime kryesore është paragjykimi, i cili nuk rëndon vetëm psikologjikisht duke prekur dinjitetin e njeriut, por edhe jetën e përditshme. Paragjykimi pengon gjetjen e punës, gjetjen e shtëpisë, gjetjen e shokut, gjetjen e integritetit. Paragjykimi është një nga prob-

lemet më të mëdha që kemi si shoqëri e jo vetëm në Itali. Deri dje e kam luftuar nëpërmjet shembullit tim, shumë emigrantëve të tjerë dhe aktivitetëve kulturorë, të cilat i kam promovuar nëpërmjet konferencave dhe mediave. Sot dua të bëj një hap më shumë, dua ta luftoj me politikën sociale të duhura. Urrejtja raciale e ka rënduar klimën në Europë e në botë, ndaj dua të punoj për një Bergamo më inkluzive, më të hapur në mentalitet, më moderne, më të bukur. Me Listën e paruar Gori të cilës kryebashkiaku i Bergamos i ka dhënë mbimërinë e tij, ka një vit që formohem, por edhe dëgjohe e konsultohem. Në çdo pjesë të programit tonë për fushën sociale, është dhe zëri im. Kam disa projekte specifike për të cilat e gjithë skuadra më mbështet. Dua të punoj për një konsullatë të popujve ku komunitetet e huaja të kenë mundësi komunikimi të drejtpërdrejtë me këshilltarët e bashkisë të qytetit ku punojmë, ku rrisin fëmijët, ku paguajnë taksat, ku jetojnë. Dua të punoj për një tavolinë rrumbullake të koordinuar më në fund nga një këshilltar bashkië ku autokton (Bergamo nuk ka patur as edhe një deri më sot). Nuk jam kandiduar për të treguar sa e integruar jam, atë e kam bërë me shumë punë të tjera nga më të përluara e deri tek biznesi, gazetaria, kultura, aktivitetet vullnetare, etj. Jam kandiduar për të punuar për një integrim më të mirë e më të shpejtë të pjesës më të dobët të shoqërisë sonë, qoftë autoktone apo jo. Jam kandiduar pasi eksperiencia e këtyre viteve dhe një skuadër efiçente ma lejoj. Nuk jam kandiduar për "t'i dhënë ngjyrë" një liste politike, jam kandiduar pasi pasioni, vullneti, dëshira, impenjimi, studimi dhe besimi i skuadrës që më mbështet, më dha shtysë e siguri. Unë jam Sonila, por jam dhe pjesë e një grupi shumë të bashkuar. Pra nuk jam vetëm e sido të shkojnë këto zgjedhje, unë nuk do jem e nuk do punoj vetëm." Mbështetja më e madhe për Sonilën në zgjedhjet e 26 majit, patjetër janë shqiptarët. Ajo ka një mesazh për ta: "Me datë 26 maj votohen administratorët e qytetit tuaj, ju bëj thirrje të shkoni të votoni! Vota është një nga të drejtat më të rëndësishme që kemi fituar me atë pasaportë, të mos e zbatosh është mëkat. Por nuk duhet harruar që vota është shprehje besimi dhe ky i fundit duhet dhënë vetëm pasi të jemi informuar më së miri mbi kapacitetin dhe aktivitetin social e politik të çdonjërit prej kandidatëve. Politika është e keqe vetëm kur bëhet keq dhe kjo varet nga zgjedhjet tona: me votën në vendosim përfaqësuesit; me votën në kemi fjalën; me votën në kemi përgjegjësinë. Ju lutem mos e shpërdorini këtë të drejtë dhe besimin tuaj." Do të doja të isha italiane vetëm një ditë. Me 26 maj. Do lija gjithçka tjetër në botë, e do të shkoja për të votuar Sonila Alushin.

Ata janë kthyer shumë shpejt në një prej çifteve më të komen tuara në showbizz-in shqiptar. Çdo detaj të ri që mësojmë nga modelja Arbenita Ismaili dhe reperi Fero, nuk mundemi ta anashkalojmë pasi vëmendja ndaj tyre është mjaft e madhe. Ata fillimisht u munduan ta mbajnë të fshehtë romancën e tyre, por nuk ia dolën dhe tashmë nëpërmjet rrjeteve sociale na tregojnë se janë shumë të dashuruar me njëri-tjetrin. Por siç duket edhe familjarët e tyre janë të familjarizuar me këtë lidhje dhe këtë e mësuam nga 'Instagrami'. Fero i ka bërë follow motrës së të Arbenitës, gazetares Almedina. Edhe ajo e ndjek reperin në 'Instagram', por pse ka pritur kaq gjatë Fero?



Fero dhe Arbenita e bëjnë lidhjen serioze? Ja hapi tjetër i reperit

Ditën e hënë, bukuroshja shqiptare Diellza Kolgeci dhe partneri i saj Fisnik Rugova janë bërë prindër të një vajze. Çifti e kanë pagëzuar voglushen me emrin Helena ndërsa nga spitali janë publikuar imazhe të ndryshme në të cilat shihej lumturia në sytë e Diellzës. Ishte Fisnik Rugova ai i cili ka ndarë me ndjekësit një foto të vajzës së tij që ia dha epitelin baba. Pranë fotos së postuar ai nuk ka shkruar asgjë vetëm se e ka vendosur një figurë bebeje me krahë engjëlli. Kujtojmë se para lindjes, Diellza dhe Fisniku organizuan një festë private 'babyshower' në të cilën e patën zbuluar edhe gjinjinë e femijes.




Sa e ëmbël! Bashkëshorti i Diellzës publikon foton e parë të së bijës

Në datën 16 maj Jonida Maliqi pritet që të përfaqësojë Shqipërinë në skenën e madhe të Eurovizionit me këngën "Ktheju Tokës". Kënga "Ktheju Tokës" renditet e 14-ta, në gjysmëfinalen e dytë të festivalit me të rëndësishëm ndërkombëtar muzikor. Mirëpo pjesë e rëndësishme e këtij kompeticioni është padyshim dhe juria dhe ditën e djeshme këngëtarja Anxhela Peristeri ka shuar kureshtjen se cila do të jetë juria shqiptare që do votojë këngët e Eurovizionit duke dhënë 50% të pikëve. Ata janë 5 duke filluar me: Anxhela Peristeri, këngëtare; Eranda Libohova, këngëtare; Dilan Reka, këngëtar; Gent Rushi, pedagog, muzikant; Julka Gramo, këngëtare, prezantuese televizive.



Lista, kush janë artistët shqiptarë në jurinë e Eurovizionit

Asnjë nuk e priste që t'i futej muzikës, por ja që është e vërtetë! Bëhet fjalë për ish-banoren e "Big Brother", Armela, të cilën e njohim të gjithë si vajza që tërhoqi vëmendjen e meshkujve brenda shtëpisë më të famshme në Shqipëri. Pasi la shtëpinë, Armela u shndërrua në një fotomodelle dhe çdo foto e saj tërhoqi sërish vëmendjen e mediave. Por së fundi, Armela ka dhënë një tjetër lajm për karrierën e saj në televizion. Shumë shpejt atë do ta shohim si këngëtare. Armela është duke punuar me një projekt muzikor që do të publikohet shumë shpejt dhe këtë e ka treguar në fotot e publikuara në 'Instagram', ku shfaqet me look-un e ri për klipin. "Muzikë e re së shpejti", janë fjalët e vetme të Armelës në 'Instagram'. Të shohim ç'suprizë na rezervon në këngën e saj që me shumë mundësi do të jetë me nota sensuale, siç është vetë Armela.



Kjo s'pritej, ish-banorja e "Big Brother" i futet muzikës

BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

POLITIK

Ngjashmëria, Jozefina Topalli prezanton dy mbesat e saj

Ish-kryeparlamentarja e Kuvendit Jozefina Topalli, edhe pse larg politikës vazhdon të tërheqë vëmendjen me jetën personale. Topalli na ka prezantuar me dy mbesat e sa të vogla Irisin dhe Angelën. Dy vajzat shfaqen të qeshura ndërkohë që shfaqin edhe ngjashmërinë e tyre me politikanen Jozefina Topalli.



Princ William dhe Kate Middleton festojnë 8 vjet martesë

Për familjen mbretërore data 29 prill është një nga më të bukurat pasi çifti Princ William dhe Kate Middleton festojnë 8-vjetorin e lidhjes në martesë. Në profilin e tyre zyrtar janë publikuar disa foto nga dita e martesës së tyre ku shkruhet: "8 vite më parë-Ju falënderojmë për letrat e ëmbla për përvjetorin e Dukës dhe Dukeshës së Kembrixh". Çifti mbretëror ka aktualisht 3 fëmijë, dy djem dhe një vajzë. Ndonëse është një nga historitë e dashurisë më të përfolura William dhe Kate kanë patur kohët e fundit disa probleme me lajmet për një tradhti të tij me komshien e tyre Rose Hunbury gjatë shtatzënisë së tretë të Kate. Familja mbretërore i ka hedhur poshtë këto aludime, madje William ka nisur procedim penal për mediat që kanë publikuar lajme të tilla.



Ia dha administrata e kohës, Musolinit i hiqet qytetaria e nderit

Këshilli bashkiak i Sarnos (Salerno), njëzëri, i ka hequr qytetarinë e Nderit që i ishte dhënë nga administrata e kohës, Benito Musolinit më 23 maj 1923. Këshilli bashkiak tani duhet vetëm të ratifikojë këtë vendim të miratuar nga ekzekutivi i qendrës së majtë të drejtuar nga kryebashkiaku, Giuseppe Canfora. "Sipas shumë historianëve, Benito Musolini konsiderohet si urdhëruesi politik i agresionit të ulët kundër Giovanni Amendola me origjinë nga Sarno emrin e të cilit e mban edhe salla e këshillit bashkiak. Qytetaria e nderit, që iu dha në atë kohë, për më tepër, përkon e papërputhshme me vlerat që mban sot bashkia e Sarnos dhe komuniteti i saj përveç se është në kundërshtim me këtë vendim", lexohet në tekstin e paraqitur para këshillit bashkiak. "Nuk mund të jemi edhe qyteti i Giovanni Amendola dhe të kemi si qytetar nderi urdhëruesin e vrasjes së tij", theksoi kryebashkiaku, Canfora.



Ish-deputeti i futet shahut, barazon me kampionin e Shqipërisë

Sahu thonë se është loja më e mirë për të stervitur dhe për ta mbajtur të freskët trurin. Ndaj ajo është një nga lojërat që po preferohet më së shumti nga ish deputetët opozitarë tani që kanë dorëzuar mandatin. Nje nga ata që po e aplikon më shumë këtë lloj terapie për të mbajtur inteligjencën zgjuar është edhe ish-deputeti i LSI-së, Përparim Spahiu. Dhe, në fakt, nuk bëhet thjesht për një angazhim amator, siç luhet zakonisht nëpër lokale apo lulishtet e lagjeve, pasi siç shihet nga fotot ai është bërë pjesë e një kompeticioni të vërtetë të zhvilluar në qytetin e Bulqizës. Dhe konkurrimi i tij nuk ka qenë thjesht për pjesëmarrje, por ai ka treguar se është një lojtar i fortë në këtë lloj sporti. Spahiu ka arritur që të dalë barazim me kampionin e Shqipërisë në shah. "Nuk e di si ndodhi por barazim me kampionin e shahut në Shqipëri. Falënderoj pa masë Mjeshtër Ndërkombëtar (IM) të shahut Landi Pasku për pjesëmarrjen në një simultane shahu në Bulqizë, pas një kampionati organizuar nga Fondacioni Jangulli", shkruan Spahiu.



RESTAURIMI



Debati/ Ministrja e Kulturës: Ndërhyrja në Gjirokastrë e domosdoshme

Fatmira Nikolli

*Elva Margariti dëgjesë
në Komisionin Parlamentar
për Edukimin dhe Mediat*

*Në komision vetëm deputetët e
mazhorancës, raportimi për
debatin e Gjirokastrës kalon pa debat*

Ky rehabilitim ka sjellë shumë debate, kjo është e vërtetë, por është po kaq e vërtetë që këto shërbime në vitin 2019 në Gjirokastrë që ne e shohim tek trashëgimia kulturore, si një motor zhvillimi ishin më se të nevojshme". Kështu u shpreh dhe ministrja e Kulturës Elva Margariti para deputetëve të mbetur në Komisionin e Edukimit në Kuvend, pas dorëzimit të mandateve nga opozita. Ministrja ishte thirrur për të raportuar në Komisionin Parlamentar për Edukimin dhe Mediat, mbi punimet në qytetin e Gjirokastrës, pasuri e UNESCO-s. Punimet mbi kalldrëm kanë ngjallur debat, për mënyrën se si kalldrëmi po rivendoset pasi u hoq dhe njëherësh për kallimin mbi kalldrëmin e ripunuar të makinave të tonazhit të rëndë.

Anëtarët e Komisionit kërkuar detaje në lidhje me detajet e projektit që përfshin Qafën e Pazarit. Deputeti Fidel Ylli përcolli shqetësimin e banorëve për pengesën që kanë sjellë këto ndërhyrje në aktivitetin e bizneseve të tyre. Ministrja Margariti u shpreh se pas inspektimeve që kreu pak ditë më parë në Gjirokastrë, ka konstatuar se punimet po ecin me shpejtësi dhe se banorët tanimë janë ndërgjegjësuar për domosdoshmërinë e këtyre ndërhyrjeve, të cilat duhet të ishin kryer më herët, për të siguruar shërbimet e nevojshme për banorët dhe bizneset e zonës.

Duke qenë se në komision mungojnë deputetët e opozitës pas tërheqjes së kësaj të fundit, raportimi i ministres pati pyetje-përgjigje pa debate.

"Nuk mund të flasim për asnjë



lloj funksioni vital, që mund të kenë këto aktivitete pa rrjetin minimal bazik, që duhet për të kryer jetesën e përditshme. Është e vërtetë që është një proces që mund të sjellë për një periudhë kohe disavantazhe në aksesimin e këtyre aktiviteteve. Megjithatë, unë i ndoqa vetë nga afër edhe janë të gjithë të sensibilizuar se është një e mirë e përbashkët, që mund të ishte kryer shumë kohë më parë edhe sot mund të ishim në kushtet optimale të rrjetëzimit të pazarit. Nuk ka asnjë aspekt teknik për mendimin tim për t'u shqetësuar, për mbivendosjen e kalldrëmeve apo të kanalizimeve. Jetojmë në një kohë, që nëpërmjet internetit të gjithë kthehen në ekspertë, por jemi totalisht të bindur, se gjithçka do punojë mirë edhe në kohën e duhur", tha Margariti.

DËGJESA

Ministrja e Kulturës, Elva Margariti foli në Komisionin e Kulturës dhe Mediat për zbatimin e ligjit "Për trashëgiminë

kulturore", me fokus në qytetin e Gjirokastrës, ku po kryhen punime rehabilituese në zonën e Qafës së Pazarit.

Sipas saj qasja e ligjit për Gjirokastrën lidhet ngushtësisht me krijimin e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore me kompetenca të qarta dhe të orientuara drejt specifikës së pasurisë botërore që Gjirokastra ka si qytet dhe krijimin e kuadrit rregullator për administrimin indirekt të disa pasurive kulturore aty ku tashmë sektori privat mundet të administrojë në mënyrë të qartë dhe të kontrolluar këto lloj pasurish.

Në fokus të fjalës së saj që edhe krijimi i modelit të qartë ligjor lidhur me rrjetëzimit të trashëgimisë kulturore, ku ndalohe në mënyrë kategorike përcudnimet e ndodhura në të shkuarën pasi tashmë forma si dhe organet e reja vendim-marrëse kolegjiale kanë që qasje evropiane në dhënie për rrjetëzimit për pasuritë kulturore dhe ku më

mirë se Gjirokastra e cila ka nevojë të rijetëzojë shtëpitë e famshme të saj që janë pasuri kulturore për ti kthyer në një funksion aktual në fushën e turizmit kulturore.

Margariti vërejti se rishikimi i gjithë kuadrit rregullator për sa i përket trashëgimisë kulturore jomateriale bën që Festivali Folklorik Kombëtar i ardhshëm i Gjirokastrës të aplikojë parashikimet e reja ligjore për sa i përket trashëgimisë jomateriale.

"Ndërsa flasim për pasurinë kulturore të Gjirokastrës nuk do të rrimë pa përmendur edhe angazhimin e ri ligjor për sa i përket peizazhit kulturor nga ku Instituti i Monumenteve të Kulturës në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe organet ligjzbatuese në fushën e trashëgimisë kulturore në nivel rajonal janë duke përgatitur hartimin e Planit Kombëtar të Peizazhit Kulturor. Ky plan do të bëjë të mundur që kryesisht aureolat peizazhore të qyteteve dhe mbi të gjitha të Gjirokastrës të konsiderohen pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore duke përcaktuar zonat mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore", tha ministrja Margariti.

INVESTIMET


Ajo renditi disa nga investimet që janë kryer në këtë qytet, pjesë e trashëgimisë botërore, nën mbrojtjen e UNESCO-s, duke u shprehur se Ministria e Kulturës në përbushje të objektivave të saj ka realizuar investime madhore në Gjirokastrë përmes rehabilitimit të Qendrës Historike e objekteve të tjera pjesë e pasurisë botërore në UNESCO.

Sipas Ministres së Kulturës, ka përfunduar faza e parë e projektit për "Restaurimin i Qafës së Pazarit, Gjirokastrë", që konsistonte në restaurimin e 8 blloqeve, me restaurimin total 5220 m² të çatave (për 8 blloqe), restaurimin e fasadave dhe kornizave, unifikimi i tyre. Restaurimin dhe prodhimin e qepenave me palosje sipas traditës vetëm në pjesën e pasme në një prej blloqeve, riparimet e gurëve të dëmtuar në fasadë, ndriçimin në fasadë dhe disa ndërhyrje të domosdoshme konstruktive. Ajo tha se projekti synon të mbrohet trashëgimia kulturore në Pazarin e Gjirokastrës, rijetëzimin e zonës si një potencial për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë lokale dhe rijetëzimin e infrastrukturës që pritet të tërheqë një numër të konsiderueshëm turistësh vendas dhe të huaj edhe duke i dhënë një hov bizneseve për të përmirësuar paketën turistike.

KALLDRËMET

Ndërkaq, vazhdon puna për projektin "Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve në Pazarin Gjirokastrë". Ky investim realizohet me fondin 137.778.274 lekë, nga FSHZH (Fondi Shqiptar i Zhvillimit) me fonde të Bankës Botërore. Punimet kanë të bëjnë me realizimin e rehabilitimit të infrastrukturës Inxhinierike, rrjetit të KUB & KUZ, rrjetin e furnizimit me ujë, energji elektrike, rrjetin e MNZ, telefonisë e rrjetit Lan si dhe restaurimin e kalldrëmeve e trotuareve, si plotësim i projektit "Rehabilitimi i Qafës së Pazarit të Gjirokastrës", pas përfundimit të fazës së parë me fasadat/çatitë e objekteve.

Analiza e Ditës



Masakrimi i buxhetit të shtetit përmes mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore

Nga Zija Lika

Ndonëse me vonesë kohore të konsiderueshme dy vjeçare, ish-ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, në mbështetje të ligjit 152 / 2013 "Për nëpunësin civil" të ndryshuar, ka nxjerrë urdhrin nr 5151, datë 28.10.2015 "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës publike, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil". Njëpërmjet këtij urdhri, është përcaktuar procedura që duhet të ndiqet nga ana e institucioneve përkatëse të administratës publike, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit të sipërmendur, lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës apo pozicionin pune të barsvlershëm (të të njëjtit nivel dhe kategori), të ish-nëpunësve civilë të larguar padrejtësisht nga puna, të cilët e konfirmojnë këtë të drejtë përmes këtyre vendimeve përkatëse gjyqësore.

Kjo procedurë përfshin ngritjen e një komisioni të posaçëm pranë secilit prej institucioneve përkatëse debitorë, i cili duhet të shqyrtojë mundësitë e sistemit (rikthimit) në një pozicion të rregullt pune të shërbimit civil, të ish-nëpunësve gjyqësorë, zotëruar të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ende të pa ekzekutuara.

Vetëm pas dërgimit nga komisioni i posaçëm tek Departamenti i Administratës Publike, të akt rekomandimit përkatës për sistemin në punë të ish nëpunësit civil gjyqësorë, ky i fundit (DAP) duhet të vijojë me nxjerrjen e aktit të emërimit.

Le të shohim se çfarë ka ndodhur në DPT Tiranë

Do të duhet të kalonin rreth 3.5 vite nga hyrja në fuqi e ligjit 152 / 2013 "Për nëpunësin civil", apo 1.5 vite nga nxjerrja e urdhrin të detyrueshëm për zbatim, të ish-ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr 5151, datë 28.10.2015 "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës publike, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", që DPT Tiranë të nxirrte në zbatim të tij, urdhrin nr 25, datë 24.04.2017 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm, për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga administrata tatimore".

Bazuar në këtë urdhr të DPT-së, komisioni i posaçëm i ngritur në zbatim të tij, në përfundim të shqyrtimit të kërkesave të gjyqësuesve (të cilat janë shpesh herë shumë të pakta, krahasuar me numrin e tyre) i propozon ish nëpunësit civil (në rast se është e mundurshme), sistemin në një pozicion pune të të njëjtit nivel dhe kategori, në zbatim të dispozitivit të vendimit gjyqësor "titull ekzekutiv".

Çuditërisht vetëm pasi ish-

nëpunësi civil, shpreh pëlqimin për sistemin në pozicionin e propozuar të punës, komisioni i posaçëm i DPT-së, i drejtohet DAP-it me akt rekomandimit përkatës, për emërimin e tij në këtë pozicion. Po në rast se ish nëpunësit civilë, zotëruar të vendimeve gjyqësore të formës së prerë ende të pa ekzekutuara, nuk kërkojnë të rikthehen në punë apo nuk e japin pëlqimin për pozicionin e punës që ju ofrohet në bazë të këtij urdhri të sipërcituar (gjë e cila ka nivel shumë të lartë probabiliteti), çfarë duhet të ndodh?! Fatkeqësisht nëse këtu ndodh kështu, në mënyrë krejtësisht të paligjshme bazuar në këtë urdhr, ndërpritet vazhdimi i mëtejshëm i procedurës përkatëse ligjore dhe të gjitha ata që refuzojnë rikthimin në pozicionin e propozuar të punës konform vendimeve përkatëse gjyqësore të formës së prerë, lejohen padrejtësisht në dem të taksapaguesve shqiptarë, të vazhdojnë të trajtohen me dëmshpërbllim përkatës në mënyrë krejt të pakufizuar në kohë (deri sa të jetojnë), ndërkohë që ligjërisht vazhdimi dhe përfundimi i kësaj procedure ligjore, duhet ta ndërpres menjëherë këtë dëmshpërbllim financiar.

Përveç sa më sipër, vonesa shumë e gjatë kohore dhe plotësisht e pajustifikuar, në lidhje me ngritjen e këtij komisioni të posaçëm nga ana e DPT-së, të ngarkuar sipas urdhrin të sipërcituar me detyrimin ligjor të gjetjes së mundësive dhe vazhdimin të procedurave përkatëse në bashkëpunim me DAP, për rikthimin në punë të ish nëpunësve civilë, konform vendimeve gjyqësore të formës së prerë ende të pa ekzekutuara, ngarkon me përgjegjësi ligjore, financiare dhe administrative, drejtuesit kryesor të kësaj drejtorie të përgjithshme, si dhe ata respektiv të drejtorive të saj juridike, apo të burimeve njerëzore.

Të dhënat statistikore të deritanishme tregojnë se, zbatimin i akteve të mësipërme në ligjore, të nxjerra me shumë vonesë sikurse themi më sipër, jo vetëm nuk e ka zgjidhur këtë problematik shumë të rëndësishme në aspektin ligjor, ekonomik, financiar, sociale të tjera, por përkundrazi e ka vështirësuar përkeqësuar edhe më tej atë. Kështu për shembull, nëse janë rikthyer në marrëdhënie pune në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, rreth 10 - 15% e numrit të ish nëpunësve civilë të administratës tatimore qendrore, të larguar më parë padrejtësisht nga puna pas vitit 2000, zotëruar të vendimeve përkatëse gjyqësore të formës së prerë, ende të pa ekzekutuara deri në fundin e vitit 2013 (kohë në të cilën hyri në fuqi ligji 152 / 2013), të paktën në periudhën e më pasme rreth 40% e këtij numri nëpunësish civilë të kësaj admini-

strate që janë larguar nga puna, i janë shtuar listës së gjyqësuesve, përfutues të dëmshpërblimeve të majme financiare, qysh prej momentit të largimit përkatës nga puna, derisa të rikthehen në të ose të jenë gjallë nëse ky rikthim nuk do të ndodh. Bazuar në ligjin në fuqi 152 / 2013 "për nëpunësin civil" të ndryshuar, nenit 66/1, pika 1, në të cilin përcaktohet se vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, duhet të zbatohen menjëherë nga "njësia përgjegjëse" e cila në bazë të nenit 4, pika 1, shkronja f, të po këtij ligji është Departamenti i Administratës Publike (DAP) për institucionet e administratës shtetërore dhe njësia e burimeve njerëzore, për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, konstatohet fare qartë se në rastin që analizojmë: DPT dhe DAP (ashtu sikurse edhe shumë institucione të tjera, që e kanë këtë problematik), janë plotësisht jo efektive për sa i takon ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të kësaj natyre.

Disa këshilla e rekomandime, për minimizimin e dëmit financiar nga statusi i nëpunësit civil. Nisur nga fakti që përgjatë 18 viteve të fundit të veprimit të ligjeve nr 8549 datë 11.11.1999 "statusi i nëpunësit civil" dhe 152 / 2013 "për nëpunësin civil" të ndryshuar, buxheti i shtetit shpenzoi çdo vit miliona euro për dëmshpërbllim, që rrjedh nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në favor të ish-nëpunësve me status të larguar më parë nga puna, në rolin e një ekonomisti finance me përvojë të gjatë pune në këtë profesion e mësimdhënje, duke qenë i obliguar të kontribuojë profesionalisht në favor të interesit publik, kam bërë publike përgjatë viteve 201, 2018 e 2019, përmes media të ndryshme vendase dhe paraqitur parandë institucioneve kryesore ligjzbatuese të vendit tonë, përmes faqeve të tyre zyrtare elektronike, disa mendime, këshilla dhe rekomandime ekonomiko-ligjore, të cilat nëse do të zbatohen do të çojnë në minimizimin e këtij dëmi financiar sistematik e të përvitshëm, duke bërë të mundur që paratë e taksapaguesve, të mos përdoren për pagesa inproduktive e parazitare, por t'u rikthehen atyre, në formën e investimeve publike, mallrave dhe shërbimeve qeveritare, rritjes së rrogave dhe pensione, politikave më të mira sociale e të tjera.

Meqëse institucione të ndryshme shtetërore (sistemi tatimor qendror, doganat në pjesën më të madhe të pozicioneve të punës, ministri, bashki e tjera), që gëzojnë ligjërisht statusin e nëpunësit civil për punonjësit e tyre, kam specifikua të ndryshme, janë përqendruar në zgjidhjen e këtij problemi në sistemin tatimor qendror, që përbëhet nga: DPT-Ti-

ranë, 13 DRT, DTM- Tiranë e tjera, ndërkohë që kjo zgjidhje mund shërbejë si model edhe për institucione të tjera me status, në vartësi me veçoritë që ato kanë.

Së pari: Duhet të bëhet rregullimi përkatës ligjor, duke ngarkuar me përgjegjësi financiare, administrative dhe/ose penale autoritetet përkatëse vendimmarrëse, për largime të padrejta nga puna, të konfirmuara përmes vendimeve përkatëse gjyqësore të formës së prerë, që lidhen me periudhat respektive nga datat e largimit, deri tek ato të marrjes formë të prerë të vendimeve gjyqësore dhe për mosekzekutim në kohë të këtyre të fundit, prej datave përkatëse që duhet të realizohet përbushja e këtij detyrimi ligjor, deri në ato të ekzekutimit të këtyre vendimeve, apo në vazhdim për pjesën e mbetur të tyre ende të paekzekutuara.

Zbatimi i pjesës së parë të këtij rekomandimi, që lidhet me largimet nga puna të ish nëpunësve civilë dhe zhvillimin e proceseve gjyqësore përkatëse deri në marrjen formë të prerë të vendimeve gjyqësore në favor të tyre, duhet të analizohet me shumë kujdes dhe objektivitet, pasi prapësia e deritanishme e funksionimit të sistemit të drejtësisë, është mbushur me raste të shumta kontestimesh, gjykimesh jo korrekte të ndershme e profesionale, të shoqëruara me ngjarje e fenomene korruptive, të denoncuar edhe prej emisioneve televizive investigative si "Fiks-Fare", "Stop", "Boom" e të tjera. Lidhur me atë çka themi, le të shprehim se funksionimi në të ardhmen i strukturave të reja të sistemit të drejtësisë, të dala nga implementimi i reformës në drejtësi, do të ndërhyjë në drejtimin e duhur realitetin përgjithësisht negativ të funksionimit të deritanishëm të këtij sistemi. Gjithashtu, këto autoritete, në përkatësi të institucioneve që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, duhet të mbajnë përgjegjësinë e sipërcituar, në të gjitha ato raste kur sipas verifikimeve përkatëse, rezultoni se kanë bërë emërim në punë nga jashtë ose brenda sistemit, në ato pozicione pune tek të cilat ato duhet të rikthenin detyrimisht, ish nëpunësit përkatës, zotëruar të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat e konfirmojnë më parë këtë të drejtë, duke lejuar në këtë mënyrë vazhdimin abuziv të pagimit inproduktiv të këtyre të fundit, me fondet përkatëse publike të buxhetit të shtetit, deri në momentin e rikthimit në vendin e mëparshëm të punës, sikurse përcaktohet në këto vendime gjyqësore, ose derisa të jenë gjallë nëse ato nuk ekzekutohen.

Së dyti: Në mënyrë që njësitë përkatëse përgjegjëse (Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës shtetërore dhe njësia e burimeve njerëzore, për institucionet e pavar-

ura dhe njësitë e qeverisjes vendore), të mund të zbatojnë normalisht konform procedurave ligjore respektive, nenin 66/1, pika 1, të ligjit 152 / 2013 "për nëpunësin civil" të ndryshuar, në lidhje me ekzekutimin e menjëhershëm të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, nevojitet që këta të fundit, të detyrohen ligjërisht të depozitojnë pranë njësive përkatëse gjyqësore të formës së prerë, që lidhen me periudhat respektive nga datat e largimit, deri tek ato të marrjes formë të prerë të vendimeve gjyqësore dhe për mosekzekutim në kohë të këtyre të fundit, prej datave përkatëse që duhet të realizohet përbushja e këtij detyrimi ligjor, deri në ato të ekzekutimit të këtyre vendimeve, apo në vazhdim për pjesën e mbetur të tyre ende të paekzekutuara.

Së treti: Për të gjithë ish-nëpunësit tatimorë, të larguar më parë nga puna dhe për të cilët aktualisht ekzistojnë vendimet përkatëse gjyqësore të formës së prerë në favor të tyre, duhet të fillojnë menjëherë nga ana e DPT-së dhe DAP-it Tiranë, procedurat e rikthimit të tyre në punë, duke i kërkuar paraprakisht qeverisë në mënyrë të argumentuar, miratimin e një shtese organike për atë sa nevojitet, në përbushje të detyrimit përkatës ligjor, që rrjedh edhe nga zbatimin e ligjit 152 / 2013 "për nëpunësin civil", të ndryshuar, neni 7, pika 2, shkronja gj.

Menjëherë pas këtij miratimi, ministria e financave konform procedurave përkatëse ligjore, duhet të transferojë fondin përkatës të parashikuar në buxhetin e shtetit për dëmshpërbllime të kësaj natyre, në fond pagash për llogari të DPT-Tiranë, duke shtuar pjesën kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që do të paguhet nga punëdhënësi (shteti) dhe rritjen totale respektive të pagës bruto krahasuar me më parë.

Ky transferim është tepër i rëndësishëm, pasi ai bën të mundur zëvendësimin e shpenzimeve buxhetore inproduktive me ato produktive, pasi këto të fundit në çdo rast do të krijojnë të ardhura shtesë nga punësimi për llogari të buxhetit të shtetit, ndërkohë që ndryshesa (ritja / ulja) e shpenzimeve faktike në kuadrin e këtij buxheti, do të jetë e barabartë me pjesën e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që do të paguarë punëdhënësi (shteti) në zbatim të legjislacionit përkatës, plus rritjen totale respektive të pagës bruto, krahasuar me më parë për të gjithë ish nëpunësit e rikthyer faktikisht në punë, minus pjesën e dëmshpërbllimit financiar të ndërprerë për ata ish nëpunës, të cilët sikurse themi më poshtë lirohen nga largimi nga shërbimi civil. Përllogarit të vlera e çdo dëmshpërbllim financiar të ndërprerë, është përafërsisht e mjaftueshme për të mbuluar koston shtesë buxhetore



të rikthimit dhe vazhimit në punën e mëparshme, të katër ish-nëpunësve zotërues të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat e konfirmonin më parë këtë të drejtë. Kjo do të thotë se vlera e dëmshpërblimit, që i korrespondon 20% të numrit total të ish-nëpunësve tatimorë të kësaj kategorie, të cilëve për shkaqet e përmendura më poshtë ju ndërpritet dëmshpërblimi financiar, është e mjaftueshme për të përballur koston shtesë buxhetore të rikthimit dhe vazhimit në punën e mëparshme, të të gjithë pjesës tjetër të barabartë me 80% të numrit total të tyre, ndërkohë që nëse shifra e mësipërme e daljes nga skema e dëmshpërblimit financiar është mbi 20%, atëherë gjenerohet përfitim shtesë buxhetor në formën e kursimit të shpenzimeve përkatëse të këtij buxheti.

Nëse për këtë kategori ish-nëpunësish, kryhen procedurat përkatëse ligjore të rikthimit në punë dhe për këtë bëhet njoftimi zyrtar i secilit prej tyre, atëherë ndërpritet menjëherë dëmshpërblimi financiar i sipërpërmendur; pasi në këtë moment madje edhe kur ekzistojnë arsye të justifikuarra ligjore për mosparaqitje në punë, efektet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nullifikohen (zerohen), ndërsa të gjithë ata që paraqesin aktin e dorëheqjes me shkrim, apo për arsye të ndryshme të pajustifikuarra ligjore nuk e reprojektojnë këtë vendimarrje, lirohen nga largohen respektivisht nga shërbimi civil dhe numri i tyre i zbritet atij të strukturës së shtuar organike të personelit, duke e fiksuar atë përkohësisht në përputhje me rregullat përkatëse ligjore.

Në përfundim të këtij procesi, do të jetë tepër e sigurt, se numri i ish-nëpunësve të kësaj kategorie që do të vazhdojnë të paguhen, do të jetë më i vogël nga ai i mëparshëm, madje me një ndryshim thelbësor tepër të madh, pasi këta të fundit nuk do të paguhen më në mënyrë inprodutive e parazitare, por nëpërmjet punës e cila padyshim dhe për çdo rast, do të gjenerojë nëpërmjet produktivitetit përkatës, përfitim shtesë me interes publik. Në lidhje me këtë, ka shumë të ngjarë që pjesa më e madhe e atyre, që kanë emigruar jashtë vendit (në Europë, SHBA, apo kontinente të tjera), apo që kryejnë punë të tjera ose merren me biznes, nuk do të preferojnë të rikthehen në vendin e mëparshëm të punës, ndërkohë që padyshim ju intereson vazhdimi sa më gjatë në kohë i përfutimit parazitar të dëmshpërblimit ekonomik, që rrjedh nga mos kryerja e procedurave përkatëse ligjore të rikthimit në punën e mëparshme, konform vendimeve gjyqësore përkatëse të formës së prerë. Sqarojmë se efektet makroekonomike bëhen edhe më negative për ekonominë shqiptare në tërësi, ju vetëm se këto dëmshpër-

blime financiare (mesatarisht prej 2-2.5 miliardë lekë çdo vit) janë tërësisht inprodutive e parazitare, por edhe për faktin se një masë e konsiderueshme e tyre (ndonëse është e vështirë të matet saktësisht), konvertohet në valuta të njohura ndërkombëtarisht si: euro, dollar amerikan, paund britanik e të tjera dhe nga ana tjetër transferohet dhe shpenzohet jashtë shtetit, kryesisht në vendet respektive ku dhe kanë emigruar së bashku me familjet e tyre (ndonëse nuk disponohen statistika të njohura zyrtare), një pjesë jo e vogël e ish-nëpunësve përkatës gjyftues, të larguar më parë nga puna sikurse themi më sipër. Nga ana tjetër bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi që vepron në RSH-së, shumat e dëmshpërblimeve financiare që buxheti i shtetit paguan çdo vit në favor të kësaj kategorie ish-nëpunësish, mund të rriten potencialisht nëse këta të fundit ngrenë padi civile pranë gjykatave respektive të juridiksionit, duke kërkuar edhe përfitimin e interesave apo kamatave, në të gjitha ato raste kur marrin tej afateve ligjore të parashikuara dëmshpërblimet takuese financiare, si rezultat i ekzekutimit me vonesë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të disponuara prej tyre.

Aktualisht janë rreth 380 ish-nëpunës të sistemit tatimor të larguar nga puna pas vitit 2000, për të cilët ekzistojnë vendimet përkatëse gjyqësore të formës së prerë në favor të tyre, por që ende figurojnë të paktyher në punën e mëparshme. Ky fakt, përbën një dëm të madh ekonomik të përvitshëm që i bëhet buxhetit të shtetit dhe taksapaguesve shqiptarë, pasi secili prej tyre ka përfutur dhe përfutur çdo vit, në vartësi me pagën përkatëse që ka patur, një shumë prej 9-10 milion lekësh të vjetra, pa dhënë asnjë lloj kontributi në punë. Duke qenë kështu, kuptohet fare qartë që shumicës së tyre apo ndoshta të gjithëve, nuk i intereson rikthimi në punën e mëparshme, madje mund ta konsiderojnë si një nga fatkeqësitë më të madha, nëse një gjë e tillë u ndodh, pasi ata mund të bëjnë punë të tjera (qoftë edhe në sektorin publik) dhe paguhen për to, të merren me biznes, e tjera, apo të emigrojnë jashtë vendit për vite të tëra dhe deri sa të arrijnë moshën e pensionist ose të jenë gjallë (gjë e cila nuk përbën aspak çudi), të paguhen dhe shtuar çdo vit në logarinë bankare të cdonjërit prej tyre, shumën prej rreth 10 milion lekësh. Përvoja e deritanishme ka treguar se kjo pagesë, mund të vazhdojë pandërprerë deri në më shumë se 60 vjet rresht, duke kapur shifrën e mbi600 milion lekëve.

Në këtë situatë, rikthimi i tyre në punë sa më shpejtë që të jetë e mundur (qoftë edhe me shtesë organike) ju vetëm që e ndërprit efektin përkatës negativ në buxhetin e shtetit, por përkundrazi mundëson lëvizjen e tij drejt kahut pozitiv, pasi kontributi (produktivi-

iteti) i punës së tyre në sistemin tatimor, i cili ende karakterizohet nga një nivel i lartë evazioni fiskal, do të shoqërohet me siguri në kushtet e mirëmenaxhimit të këtij sistemi, me një rritje të ardhurash për buxhetin e shtetit disa herë më shumë se rrogat përkatëse të tyre, të cilat vazhdojnë t'i marrin sistematikisht në periudha periodike vjetore, në mënyrë inprodutive e parazitare, madje dhe pa zbritur më parë kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sikurse ndodh me të punësuarit.

Pra zbatimi i kësaj skeme ekonomiko-ligjore në çdo lloj rasti dhe rrethane, do të rezultojë me efektfinanciare pozitive për buxhetin e shtetit dhe do të ulë nga ana tjetër, treguesin në % që zë kostoja reale vjetore e mbajtjes së personelit të administratës tatimore qendrore, të cilës i shtohet edhe dëmshpërblimi vjetor i sipërcituar, ndaj totalit të të ardhurave vjetore që vilen prej kësaj administrate, ndërkohë që vonesat subjektive të pajustifikuarra nga ana ligjore, lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (për sa i takon rikthimit në vendin e mëparshëm të punës, të ish-nëpunësve përkatës të larguar më parë nga puna), apo akoma më keq mosekzekutimi fare i tyre, do të vazhdojnë të ndëshkojnë financiarisht këtë buxhet dhe taksapaguesit shqiptarë. Mundësia e rikthimit në punë, për raste të tjera të ngjashme, qoftë edhe me shtesë organike deri në masën ku të ardhurat e produktit marxhinal të punës barozojnë cmimin e saj (pagën), sikurse përcakton shkenca e ekonomisë, duhet të shikohet më përparësi edhe në institucione të tjera ku vepron ligji përkatës "për nëpunësin civil", duke përfshirë edhe njësitë e qeverisjes vendore.

Në këndvështrimin ligjor, ekonomik, financiar dhe social, çdo shtesë organike e miratuar konform procedurave përkatëse ligjore, që do të mundësonte rikthimin në punën e mëparshme të ish-nëpunësve të kategorisë së lartpërmendur; do të ishte e justifikuar deri në masën që treguesi ekonomik "të ardhura të produktit marxhinal të punës", të jetë jo më i vogël se pjesa e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që paguan punëdhënësi (në rastin tonë shteti), në zbatim të legjislacionit përkatës, plus rritja respektive e pagës bruto krahasuar me më parë, pasi pjesa tjetër e shpenzimeve që lidhet me pagën, mbulohet financiarisht nga fondit përkatës i parashikuar në buxhetin e shtetit për dëmshpërblime dhe i transferuar më parë në fond pagash, sikurse themi më sipër.

Së katërti: Është e domosdoshme dhe emergjente që në kuadrin e rregullimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit në fushën e shërbimit civil e të tjera, të përcaktohet qartë se nëse përgjatë periudhës kur ish-punonjësi civil apo jo civil, është trajtuar apo trajtohet me dëmshpërblim financiar nga fondet e buxhetit të shtetit për shkak të ekzekutimit të vendimit përkatës gjyqësor të formës së prerë në favor të tij dhe nga ana tjetër brenda kësaj periudhe, verifikohet se ai ka qenë apo është i punësuar në sektorin publik dhe për pasojë i paguar prej fondeve publike buxhetore, atëherë këto shuma pagesash duhet t'i zbriten atij prej dëmshpërblimit të pritshëm, ose të kërkohej rikthimi i tyre në buxhetin e shtetit, përmes vendimit ekzekutiv të nxjerrë prej institucionit përkatës, konform zbatimit të procedurave të nevojshme ligjore. Nga ana tjetër bazuar në praktika të njohura të legjislacionit ndërkombëtar që vepron në këtë fushë në vende të ndryshme demokratike të botës, përfutitës i lartpërmendur të kësaj kategorie, apo të disa prej rasteve të tjera të parashikuara në legjislacionin përkatës, (të cilat lidhen me pagesën e papunësisë, mbrojtjen sociale e të tjera), e humbasin këtë të drejtë, nëse verifiko-

het se kanë qëndruar jashtë vendit përkatës në mënyrë të vazhdueshme apo me ndërprerje, më tepër se 183 ditë në një periudhë prej 365 ditësh.

Së pesti: Në Ligjin 152 / 2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, neni 66/1, pika 4, citohet se: "Njësitë përgjegjëse është e detyruar që në momentin e krijimit të një vendi pune të lirë në shërbimin civil, të emërojë, fillimisht me pëlqimin e tyre, nëpunësit civilë (gjyftues) të regjistruar në listë, sipas kategorisë përkatëse dhe që plotësojnë kriteret e pozicionit të punës".

Duke qenë se zbatimi në praktikë i këtij neni, është shoqëruar me spekulime, afëra korruptive e të tjera, të cilat kanë gjeneruar pasojë të rënda e të vazhdueshme negative, veçanërisht ndaj buxhetit të shtetit dhe taksapaguesve shqiptarë, nevojitet që kjo pikë e këtij neni të ndryshojë, duke hequr shprehjen e lartpërmendur fillimisht me pëlqimin e tyre", në të gjitha rastet kur nëpunësit civilë gjyftues, në zbatim të dispozitivit të vendimit gjyqësor "titull ekzekutiv", rikthehen në vendin e mëparshëm të punës, ose duke përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të prerë, se këta nëpunës civilë gjyftues, nuk mund të refuzojnë më shumë se një herë sistemin në një pozicion tjetër pune të të njëjtit nivel dhe kategori, në të cilin plotësojnë kriteret përkatëse, ndërkohë që nëse shteti merr përsipër paraprakisht, trajnimin përkatës falas, afatshkurtër dhe të detyrueshëm të tyre, refuzimi (përvetse përkohësisht dhe në rrethana të parashikuara e arsyetuar ligjorisht), të konsiderohet i pajustifikuar dhe i papranueshëm nga ana ligjore. Mospjesëmarrja e pajustifikuar në këtë trajnim, nga ana e nëpunësit civil përkatës, të konsiderohet thyerje e rëndë disiplinore, duke përbërë shkak për largim nga shërbimi civil dhe ndërprerje të menjëhershme të trajtimit me dëmshpërblim financiar.

Përfutimet që rrjedhin nga implementimi i këshillave dhe rekomandimeve ekonomiko - ligjore të lartpërmendura.

Gjykoj se duke vepruar në këtë mënyrë, bëhet e mundur që të merren një sërë përfitimesh në drejtime dhe aspekte të ndryshme, të cilat padyshim do të jenë në interes të mbarë publikut dhe vlerësohen pozitivisht prej tij.

Në aspektin ligjor, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, merr një rëndësi edhe më të madhe në kushtet e sotme të implementimit të reformës në drejtësi dhe çeljes së pritshme të negociatave për anëtarësim të vendit tonë në bashkimin europian. Në të gjitha vendet e botës ku funksionon realisht shteti ligjor i së drejtës, ju vetëm që ekzekutohen në kohën e duhur këto vendime, por aktualisht në disa prej tyre si SHBA, Gjermani e tjera, legjislacioni përkatës me qëllim minimizimin e pagesave inprodutive, kushtëzohet dhënie e asistencës ekonomike për të gjithë individët përfitues në moshë ligjore pune dhe të aftë për punë, me kryerjen përgjatë çdo muaji të një numri të caktuar orësh pune në doli të komunitetit.

Në aspektin ekonomik, sikurse e shpjeguem më sipër, bëhet e mundur të shmangen ose të paktën minimizohen, pagesat e majme, sistematike, inprodutive e parazitare, që kapin çdo vit në total shifra prej disa milionë euro për këtë kategori ish-punonjësis të sipërpërmendur, të cilët mund t'i përfutnë ato në vazhdimësi deri në më shumë se 60 vjet, nëse nuk kryhen procedurat përkatëse ligjore të rikthimit në punën e mëparshme.

Nga ana tjetër ekzekutimi në kohën e duhur i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, minimizon kostot e problematikave me të cilat mund të përballen në të ardhmen, ish-nëpunësit përfitues të dëmshpërblimeve financiare dhe institu-

cionet përkatëse shtetërore, në të gjitha ato raste kur gjykata e lartë (shkalla më e lartë e gjyqësorit), në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të rekursve përkatëse (gjë e cila nisur nga përvoja shqiptare e deritanishme ndodh pas disa vitesh), vendos shfuqizimin e vendimeve të dhëna më parë nga gjykatat përkatëse të apelit, të cilat pas marrjes formë të prerë të tyre, janë ekzekutuar vetëm për efekt dëmshpërblimi financiar dhe për pasojë duhet të realizohet sipas procedurave respektive ligjore, rikthimi mbrapsht në buxhetin e shtetit i shumave të dëmshpërblimeve financiare të tërhequra më parë nga përfituesit përkatës, të cilët nëse i kanë shpenzuar ato më parë dhe nuk kanë burime të tjera të mjaftueshme financiare, vështirësohet së tepërmi dhe ndoshta bëhet i pamundur rikthimi në fjalë i sipërcituar.

Në aspektin social, rikthimi sa më shpejtë të jetë e mundur në vendet e mëparshme të punës, konform vendimeve përkatëse gjyqësore të formës së prerë, të ish-punonjësit të larguar më parë nga puna, minimizon kostot sociale që lidhen me zhvlerësimin e kapitalit injerzohet dhe intelektual, të shkaktuar nga humbja e aftësive profesionale dhe shprehive të punës, si rrjedhojë e qëndrimit papunë, apo punësimi jashtë profesionit.

Në aspektin e luftës antikorruptive, ekzekutimi sa më i shpejtë i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për pjesën që i takon rikthimit në vendin e mëparshëm të punës, të ish-punonjësit që e kanë fituar këtë drejtë me këto vendime, do të shpang në të ardhmen, afërat korruptive që mund të jenë praktikuar në të kaluarën në sistemin gjyqësor, lidhur me dhënie e së drejtës së pamerituar (tek disa prej ish-punonjësit të larguar nga puna), kundrejt shpërblimeve korruptive të dhëna, pasi çdo vendim i kësaj natyre ju ka siguruar dhe siguron atyre, çdo vit në vazhdimësi mesatarisht rreth 10 milion lekë të vjetra.

Në aspektin moral, shoqëror e politik, duke vepruar si më sipër, kontribuohet pozitivisht në drejtim të dhënies fund, ju vetëm të pagesave të majme parazitare që shpesh zgjaten pa limit kohor në dëm të interesit publik, por edhe të spekulimeve hipokrite të një pjese të ish-punonjësit të kësaj kategorie, që ndërsa hiqen cuditërisht "të persekutuar", (megjithëse trajtohen me rroga të larta papunuar), tundin ju rrallë herë flamujt e opozitarizmit, në pritje dhe me ëndërr për t'u kuptuar në të ardhmen, në poste drejtorësh në mënyrë të pamerituar.

Vetëm kështu, aq më tepër të ndodhur përballë implementimit të shumëpriritur të reformës në drejtësi dhe çeljes së negociatave për anëtarësim të vendit tonë në bashkimin europian, bëhet i mundur zbatimi korrekt i legjislacionit mbi ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, shmangia ose minimizimi i pagesave inprodutive e parazitare, të cilat kapin vlera monetare relativisht shumë të larta, eliminimi i mundësisë të emërimeve të reja të pamerituar dhe dubluara përmirësimi i eficientësisë ekonomike në sistemin tatimor e tjera, duke kontribuar pozitivisht në rritjen e mirëqenies ekonomike e sociale të mbarë publikut.

Shpresoj që këto mendime, këshilla dhe sugjerime të karakterit ekonomik - ligjor, të merren në konsideratë dhe implementohen nga institucionet përkatëse ligjzbatuese dhe ligjvënës shqiptare, pasi ato përveç të tjerash, do të rezultojnë çdo vit në të ardhmen me efekte financiare pozitive, prej disa milionë euro në favor të buxhetit të shtetit dhe interesit publik.

Opinion

i Ditës

Çfarë mësuam nga samiti i Berlinit?

Nga Spartak Ngjela

(vijon nga faqja 1)

...qëndrojmë".

Njëllor si psikologjia e Milosheviçit.

Kur Ollbruk i tha Milosheviçit në vitin 1999 se "ti do bombardohesh", ky as që pyeti fare dhe qëndroi si stoik, i bindur që asgjë nuk mund t'i bënin dot. Dhe, a e dini se çfarë i kërkoi presidenti Klinton atëherë: autonomi të gjerë të Kosovës, sipas Kushtetutës së vitit 1974.

Por, nuk u tërhoq Milosheviçit, se e dinte veten shumë të fortë ushtarakisht, madje kishte edhe mendimin se fitonte çdo luftë.

Në fakt, nuk ishte vetëm Milosheviçit që nuk besonte te bombardimet, por as kryeministri grek, Simitis. Ky iu thoshte filogrekëve të Partisë Socialiste: "Janë fjalë, kurrë nuk mund të bombardohet Jugosllavia". Por, mbasi filluan bombardimet, u tremben të gjithë fqinjët pushtues tokash shqiptare.

1.

Jof Bërtiti atëherë Milosheviçit.

Dhe sapo filluan bombardimet, deklaroi: "Ne kurrë nuk do të thyhemi". Mendoj të krijonte një Vietnam të ri për Amerikën. Por, shpejt kapituloi me turp, pasi kishte kryer pastrim etnik dhe krime barbare në Kosovë.

Humbi dhe iku me gjithë lavdinë false që kishte krijuar në mendje.

Ky i sotmi, presidenti Vuçiç, është krejt i njëjti. "Nuk mposhtemi", tha dje, ashtu siç kishte thënë dhe Milosheviçit. Është njëllor me psikikën e Milosheviçit, me një ndryshim: Milosheviçit kishte de-



lir skizofrenik për forcë ushtarake, kurse ky i riu ka delir për politikë sorollatëse, sa të lodhë Perëndimin, kur nuk ka asgjë në dorë.

Në fakt, kjo është e njëjta psikologji dyqindvjeçare, sepse vetë Serbia është një investim ruse-francez i gjithi në falsitet. Serbia ishte një bërthamë e vogël si principatë e vogël rreth Beogradit, e cila pushtoi gjashtë herë territorin e principatës së vet dhe u zgjerua me territoret shqiptare nga Nishi e deri në Prishtinë. Terror dhe gjenocid antishqiptar është historia e tyre, e cila pas 200 vjetësh erdhi e vulli dhe e nxori jashtë të gjithë vrerin e saj shekullor me Milosheviçin, derisa humbi përfundimisht.

Por, presidenti aktual i Serbisë, në fakt, ka qenë ministër i Milo-

sheviçit kur ky kapitulloi në vitin 1999. Prandaj, sigurisht që, edhe Vuçiç nuk del dot nga psikoza reaktive e Milosheviçit, sepse edhe ky është brenda psikozës së tij reaktive, me tezën se "pa Kosovën, Serbia humbet historinë e saj dhe s'ka Serbi".

ll.

Por, dje e panë të gjithë se Vuçiç ishte sikur po shkote drejt fundit të vet. Njëllor si Milosheviçit, dhe po kuptohet saktë se krejt i njëjtë me të është edhe ky. Kokëngjeshur që nuk kupton historinë, sepse është pjesë nga i njëjti vrer. Duan të rimarrin territoret e dikurshme të Kosovës dhe sillen vërdallë për të fituar kohë me endërrimin e tyre patologjik të racës serbe. Vazhdojnë me propagandë të ethshme banale kundër

shqiptarëve dhe e heqin veten si mbrojtës të krishtërimit kundër turqve.

Ku ka turq në Shqipëri, zotërinj?! Feja nuk është kombësi. Kurse për krishtërimin e saj, politika serbe gënjen. E dini se çfarë janë priftërinjtë e kishës serbe? Oficerë dhe ushtarakë të shërbimit. Kjo është historia e saj. Ku ka Krisht që pranon krimet e tyre monstruoze!

Po mirë, këta "kristianë të devotshëm", që kanë qenë në mesjetë aleatë besnikë me Stambollin osman, e dinë mirë historinë?

E dinë, por bëjnë sikur nuk ka ndodhur. Vetë hiqen sikur po mbrojnë krishtërimin nga islami shqiptar, por këtu brenda, me veglat e tyre duan t'u mbushin mendjen shqiptarëve se Skënder-

beu ka luftuar për fe dhe jo për atdhe, për të sjellë rrëzimin e historisë së lavdisë shqiptare të luftërave kastriotiane, kur këta vetë ishin aleatë me Stambollin. E kuptoni vobektësinë e mendjes barbare se ku të çon?

Por...

Histori është edhe kjo:

Në vitin 1924 shqiptarët sollën në pushtet si kryeministër një peshkop kristian ortodoks, Fan Nolin. Me një qeveri më bazë ortodokskatolike. E dini se çfarë ndodhi?

Kryeministri serb Pashiç, me ushtri, e rrëzoi me dhunë një peshkop të krishterë dhe sollë në pushtet një ish-pasha turk, Ahmet Zogun. E kuptoni tani që ata nuk kanë fe, por janë historikisht një detashment ushtarak i mbytur deri në grykë me krime? A e dini që ato manastire të Kosovës që po shtiren sikur i mbrojnë, janë manastire të krishtërimit shqiptar kur këta vetë, serbët, kanë qenë stepave si paganë; por që i kanë marrë me dhunë, pas islamizimit të Kosovës dhe me ndihmën e Sulltanit? Do t'i dëgjoni. Mos u mërzisni. Prisi edhe pak.

Por, kot e kanë. Askush nuk i beson më në përrallat e tyre antishqiptare dhe kot shpenzojnë miliona, asgjë nuk i bëjnë dot. Por, njëllor si edhe politika ruse, kanë shumë shpresë të korupsionit shqiptar. Edhe këtu kot lodhen. Beogradit politik e pa shumë mirë në Berlin dje si u varros përfundimisht çështja e ndërrimit të territoreve dhe se si u fundos përfundimisht politika Vuçiç-Thaçi-Rama për ndërrimin e territoreve.

Por, edhe pse aq i vrarë sa u duk kur doli dje nga takimi me kancelaren Merkel, ende ka shpresë ky president se mund të vijojë të ecë në falsitet!

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



Opinioni *i* Ditës

Një impuls i ri për çështjen e Kosovës?

Nga Adelheid Feilcke

(vijon nga faqja 1)

...Perëndimor. Ai është edhe emëruesi i përbashkët i një politike mes Berlinit e Parisit, që nuk është pa dallime, kur vjen puna të Ballkanit Perëndimor. Por, edhe një pikënisje realiste pozitive, që artikulon qartë interesin për Ballkanin, pa pasur pritshmëri të kota dhe ndezje shpresash.

Në samitin për Ballkanin Perëndimor në Berlin që në fillim të dy politikantët e nivelit të lartë nuk e fshehën se për çfarë nuk do të bëhet fjalë në këtë takim joformal: Nuk do të flitet për perspektivën europiane, as për Procesin e Berlinit dhe as "për t'i diktuar një zgjidhje" Prishtinës dhe Beogradit në konfliktin për çështjen e Kosovës. Se përse do bëhej fjalë më shumë, edhe kjo u bë e qartë: Siguria, luftimi i kontrabandës së armëve, terrorizmi, migracioni i pakontrolluar dhe kriminaliteti i organizuar. Këto janë interesat e përbashkët prioritarë për rajonin.

KUJDES ME STABILOKRATËT

Prioriteti i stabilitetit e bën politikën për Ballkanin Perëndimor konsekuente dhe të argumentueshme në Europën e BE-së, por ai duhet të përplotësohet politikisht. Sepse në fund stabilitetin e dëshiruar mund ta garantojë vetëm një partner i besueshëm politikisht. Dhe besueshmëria e politikës funksionon edhe në Ballkanin Perëndimor përmes organeve demokratike të kontrollit dhe politikës demokratike të legjitimuar. Kush nuk e merr seriozisht sa duhet sot shtetin ligjor, nuk ka për të qenë aq serioz edhe në politikën e jashtme. Të besosh tek stabilokratët, që vërtet zbusin valët e refugjatëve, por gërryejnë nga brenda demokracinë është dritëshkurtësi. Gabimet e bëra në rajone të tjera nuk duhet të përsëriten në Ballkanin Perëndimor! Prandaj është shumë e vlerësueshme që megjithatë, në fund të këtij samiti të Ballkanit Perëndimor dolën konkluzione politike të bashkëiniciatorëve gjermano-francezë. Ato u sjellin ndërmend pjesëmarrësve ndër të tjera detyrimin "për qëndrim të patundur pro demokracisë, shtetit ligjor dhe akte të përgjegjshme shtetërore, për luftimin e korrupsionit si edhe forcimin e rolit të shoqërisë civile dhe mediave të pavarura". Letra thuhet se është durimmadhe. Por do të kishte qenë fatale, nëse ky sinjal nuk do të jepej.

Pikërisht ndërlidhja e interesave të stabilitetit dhe një politikë europiane e orientuar nga e ardhmja bëri që të arrihej vitin e kaluar një sukses historik në grindjen dhjetëvjeçare mes Greqisë dhe



Maqedonisë së Veriut. **EFEKTI I KËMBËNGULJES SË MERKELIT DHE MACRON**

E, parametra të tillë duhet të jenë vijat orientuese edhe në zgjidhjen e konfliktit të Kosovës. Grindja mes Prishtinës dhe Beogradit ishte ndoshta arsyeja më urgjente për thirrjen e samitit, por edhe detyra më e vështirë e tij: duhej të fshihej përfundimisht nga tryeza e bisedimeve ideja e korrigjimit të kufijve në kompensimin mes Kosovës dhe Serbisë, një "deal"

që presidentët e të dyja vendeve me mbështetjen amerikane prej muajsh e kishin sjellë në skenë. Kjo bëri që në kryeqytetet europiane të binin sirenat e alarmit. Sepse u thye një tabu: Zhvendosja e kufijve si pjesë e një kompensimi bilateral. E jo pa të drejtë shumë i tremben një efekti negativ në vendet fqinje, veçanërisht në Bosnje-Hercegovinë, një konstrukt i brishtë i rrezikshëm nga thyerje të tilla tabush etnopolitike. Këmbëngulja e Merkelit dhe Macron për një dialog të

udhëhequr nga BE e dha më në fund një efekt: Serbia dhe Kosova duan sërish të futen në dialog nën ndërmjetësimin e BE-së, me qëllimin e arritjes së një marrëveshjeje të zgjeruar dhe përfundimtare, që i shërben stabilitetit në rajon dhe hap rrugën drejt Europës.

Sikur gjysma e konkluzioneve të këtij samiti të çohet seriozisht përpara, atëherë ky samit arriti shumë: Mbi bazën e interesave të përbashkëta të stabilitetit arrihet uniteti mes Gjermanisë dhe Francës në politikën për Ballkanin Perëndimor. Ky duet i fuqishëm europian sjell kështu një dinamikë të fuqishme në proceset e ngecurra apo të orientuara gabim në rajon, sidomos në marrëdhënien mes Kosovës dhe Serbisë. E rëndësishme është që ky impuls dhe presion të mbahet gjallë nga Berlini dhe Parisi. Ndryshe ato do të bëheshin shpejt pluhur diku mes Beogradit e Prishtinës.

Stabiliteti në Ballkan është në interes të Europës - me këtë formulë, Franca dhe Gjermania gjejnë një emërues të përbashkët në politikën për Ballkanin Perëndimor. Por kjo nuk mjafton, mendon Adelheid Feilcke.

HOROSKOPI

DASHI

Keni bërë një rrugë të gjatë dhe është koha për të shijuar shpërblimet e punës suaj. Nëse mendoni se mund të vazhdoni të ecni përpara pa pushim, keni shpresa joreale për veten. Ju nuk jeni robot!

DEMI

Sot ka shumë gjëra që ju duken të pagurta. Si rezultat i kësaj, këshilloheni të mos merrni vendime të rëndësishme. Sa i përket aspektit sentimental, sot mund të takoni një person, i cili me kalimin e kohës mund t'ju duket interesant.

BINJAKET

Ndjejeni sikur keni qenë të mbërthyer në një rreth vicioz sot? Yjet thonë se ajo që ju duhet është një pikëpamje e re! Në mënyrë që t'i japësh vetes një perspektivë të re të re për jetën, shkëputuni nga rutina juaj normale.

GAFORJA

Është e vërtetë se edhe duke shpenzuar para mund të fitoni para, por duhet të keni një "stomak" të fortë për të rrezikuar, në mënyrë që t'ia dilni mbanë. Jini shumë të kujdesshëm se ku i investoni paratë.

LUANI

Nëse ndonjëherë fshiheni kur dikush ju sulmon, sot duhet të ngriheni dhe të bëni rezistencë. Ndryshimi i taktikave në mënyrën e reagimit do t'ju mbajë në formë të shkëlqyer. Mos harroni, jeni shenjë zjarri.

VIRGJERESHA

Rutina juaj e përditshme është gati të troiditet pak sot. Disa surpriza janë drejtuar në rrugën tuaj dhe mund t'i thoni lamtumirë mëzisë! Një person që nuk ju pëlqen mund të largohet nga jeta juaj.

PESHORJA

Shmangni rrugën e shkurtër dhe bëjini gjërat me ngadalë. Kjo vlen veçanërisht për romancën! Nuk ka asnjë arsye për t'i përshpejtuar gjërat, ndaj përpiguni t'i arrini synimet që keni në mënyrë graduale.

AKREPI

Çdo trazirë e brendshme që përjetoni sot do të zhvishet nga problemet me të cilat përballet rrethi juaj shoqëror. Edhe pse mund të keni probleme të mëdha, tregohuni altruist duke u ardhur në ndihmë miqve tuaj.

SHIGJETARI

Mundohuni të lidheni me një person, i cili ju ka munguar për një kohë të gjatë. Keni nevojë për urtësinë e këtij personi, në mënyrë që të kuptoni idetë tuaja të reja dhe ndryshimet që kanë ndodhur në jetën tuaj kohë e fundit.

BRICJAPI

Sot do t'ju jepet një ide, ose një mundësi për të bërë ndryshime të thella në aspektin profesional. Po kaloni një moment transicioni, i cili vjen në jetën tuaj për mirë. Kapani momentin!

UJORI

Ju nuk mund ta kuptoni, por fjalët tuaja mund t'i bëjnë njerezit të lëvizin, sidomos tani kur universi ju jep një kombinim unik të pasionit, inteligjencës dhe elokucencës. Ju nuk mund të jeni ende të kënaqur me fuqinë që keni, por duhet pajtë të vini atë zbatim.

PESHQIT

Sot do të luani rolin e vizionarit në një situatë tensioni. Përpiguni të tregoni vullnet për të zgjidhur një situatë, e cila prej kohësh ka qenë e komplikuar. Në çështjet e dashurisë keni nevojë për një eksperience të re.

VOLEJBOLL FEMRA



Partizani i volejbollit të femrave ka dominuar dhe fituar titullin kampion për herë të dytë radhazi, kësaj radhe duke mposhtur në finalen e madhe Tiranën. Vajzat e kuqe të drejtuara nga Roland Tarja udhëhiqnin serinën 2-0 dhe luanin në "Farie Hoti" sfidën e tretë të finaleve, ku fituan sërish, kësaj radhe duke triumfuar 3-2 dhe

Partizani kampion, thyen Tiranën 3-2 në sfidën e tretë

duke merituar çmimin e madh. Ka qenë një sezon i mrekullueshëm ky për volejbollin e Partizanit, me meshkujt dhe femrat, të dyja skuadrat në finale dhe me femrat që sapo janë kurorëzuar kampione,

ndërsa meshkujt kanë fituar finalen e parë ndaj Vllaznisë. Sfidat e djeshme ka qenë e luftuar dhe Tirana ka kërkuar me çdo kusht të rikthehej në lojë, teksa ndryshe nga dy sfidat e para, është dashur edhe

seti final, pasi ndeshja shkoi në 2-2. Por në setin final, skuadra e Tares nuk ka zhgënjyer, duke krijuar një shkëputje të madhe në 13-7 dhe pa vënë në diskutim fitoren finale 15-8, të udhëhequra nga Xheko, Tuci, turkja Bajramoglu dhe kubanezja Kasalis, lojtarja më e mirë e ekipit të kuq.



Jeton Selimi

Trajneri deklaron se në barazimin ndaj Teutës kishte në dispozicion vetëm 12 lojtarë

Gjoka: Nuk e sakrifikoj vendin e dytë për Kupën

Te Kukësi nuk mendojnë ende për merkaton

Kthimi i Ernest Gjokës në pankinë e Kukësit ka qenë një nga rikthimet që ka bërë më shumë bujë në kampionatin shqiptar në vitet e fundit. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe, duke kujtuar se Gjoka ishte trajneri i parë që u shpall kampion me Kukësin, por edhe që u largua jo edhe aq miqësisht nga ky klub me thumbime e deklarata mes palëve. Por duket se gjithçka i përket të kaluarës dhe Gjoka mori pak më shumë se një viti e gjysmë përsëri drejtimin e klubit, duke e drejtuar atë prej disa javësh në kampionat e Kupë. Por, çfarë Kukësi ka gjetur Gjoka në këtë rikthim dhe cilat janë planet për vijimin e sezonit? A është gati ekipi verilindor të bëjë sakrificat në kampionat dhe çfarë po "gatuhet" për verën? Vetë trajneri shuan disa nga këto kuriozitetet në intervistën e tij për "VIP Sport", ku konfirmoi gjithashtu se klubi ka vendosur objektiva të qarta për vijimësinë.

Tashmë u bënë disa javë nga emërimi i tuaj përsëri në stollin e Kukësit. Sa kanë ndryshuar gjërat në skuadër? A janë ambientuar lojtarët me filozofinë tuaj?

Në këto javë që unë jam rikthyer në ekipin e Kukësit,



mendoj që disa gjëra janë më të qeta se në momentin që erdha dhe besoj që ju e dini të gjithë që situata këtu nuk ishte e mirë. Sigurisht që po përpiqemi së bashku me

ekipin për të kapur sa më shpejt atë që ne si staf po kërkojmë dhe unë i falënderoj lojtarët që po më ndjekin shpejt dhe kanë besim tek ne si staf.

Ka kaluar më shumë se një vit e gjysmë, çfarë keni gjetur ndryshe nga sa e keni lënë të Kukësi kur u larguat?

Po sigurisht, gjërat janë komplet ndryshe, sepse ekipi është ndryshuar në tërësi dhe çdo trajner që ka qenë, ka pasur idenë e tij. Kështu, mua tashmë më duhet të ndryshoj gjërat sipas stilit tim.

Ku po has më shumë vështirësi skuadra në këto javë të para tuajat?

Problemi kryesor kanë qenë dëmtimet. Unë për pesë ndeshjet që kam pasur deri më tani kam pasur në dispozicion vetëm 12 lojtarë dhe me këta jemi munduar të bëjmë gjithçka.

Si është tani gjendja e skuadrës sa u përket rikthimeve dhe dëmtimeve?

Tani po mendohe mi të bëjmë gati sa më shpejt Ramën, i cili për mua është një potencial në skuadrën e Kukësit dhe një vlerë e shtuar

ar e Superiores sonë. Po rikuperojmë Dzarian, që pati një pneumoni dhe tashmë po vijojmë ta sjellim në parametrat e duhur fizikë. Kemi Shametin, që po kalon një dëmtim të ligamentit të brendshëm të gjurit dhe po përpiqemi ta rikuperojmë, ndërsa Maliqi dhe Krasniqi e kanë mbyllur këtë sezon. Kjo është situata e momentit.

Kukësi po pëson gola nivë me gabime individuale. Si mund të rregullohet kjo?

Nuk e shikoj kështu. Nën drejtimin tim, skuadra ka pësuar tre gola dhe sigurisht në futboll bëhen edhe gabime. Por, ne së bashku po përpiqemi t'i sistemojmë gjërat.

Duke qenë se Kupa është objektiv, a do ta sakrifikonit vendin e dytë për të?

Jo, absolutisht që jo. Vendi i dytë është obligim për të gjithë ne, ndërsa Kupa është një kompeticion tjetër dhe me

shumë kujdes po mendohe mi të përgatitemi për ndeshjen e kthimit në Korçë. Sigurisht që Kukësi duhet të kërkojë trofe, sepse është ndërtuar për të qenë skuadër elitare. Por, gjithmonë me këmbë në tokë dhe me qëndrim maksimal.

Megjithëse është ende herët, a keni filluar të mendoni për merkaton? Ku mendoni se Kukësi ka më shumë nevojë për afrime?

Jo, është akoma shumë herët për mua kjo gjë. Unë kam disa objektiva të vëna së bashku me presidentin për këtë sezon dhe duhet të luftoj për këto objektiva. Në fund është merkato. Por, për mendimin tim Kukësi ka një skuadër të formuar me kujdes dhe me cilësi dhe unë po të kem fatin të vazhdoj një projekt njëvjeçar, do të jem i lumtur të jem së bashku me këtë grup.

VENDIMI I FSHF-së

Frikë nga tolerimet, java e 32-të luhet në një orar

Eshtuna do të jetë një ditë futbolli ndryshe në Kategorinë Superiore dhe kjo për shkak të rivalitetit të ndezur mes klubeve, kryesisht në luftën për mbijetesë dhe zonën europiane dhe disi më pak sa i takon titullit, ndonëse një humbje e Partizanit në Vlorë do ta ngushtonte me 7 pikë diferencën mes të kuqeve dhe verilindorëve. Por gjithësi, janë dy zonat e mëdha të betejës, ajo për mbijetesë dhe zonën e Kupave të Europës, që e kanë



detyruar Federatën Shqiptare të Futbollit të unifikojë oraret e 4 sfidave të javës. Kështu, të gjitha përballjet do të startojnë në orën 15:00, ndërsa

SUPERLIGA	
JAVA E 32-TE	
TE SHITUNEN	
Laçi-Kastrioti	15:00
Tirana-Skënderbeu	15:00
Flamurtari-Partizani	15:00
Teuta-Luftëtari	15:00
Kamza-Kukësi (0-3 në tavolinë)	

Kukësi merr 3-pikëshin në tavolinë, pasi këtë javë kalendari i rezervon ndeshjen me Kamzën e përjashtuar. Ja edhe programi i Superligës.

SKËNDERBEU

Shehi me 'dhimbje koke', humbet Radasin e Ditën para Tiranës


Pashka solli festë në gytetin e Korçës, Skënderbeu u rikthye te fitorja dhe këtë e bëri pikërisht në momentin më të rëndësishëm të sezonit, përballë një rivali direkt si Flamurtari. Ai trepikësh i kthen edhe një herë në garë për të siguruar një vend në Kupat e Europës, një objektiv që korçarët dëshirojnë t'i shkojnë deri në fund, në pritje të vendimit përfundimtar nga KAS. Këtë fundjavë udhëtojë drejt kryeqytetit ku i pret Tirana, një skuadër gjithashtu e etur për pikë. Intere-



sant është fakti që Skënderbeu nuk ka fituar asnjë përballje këtë sezon kundrejt bardhebluve, 2 barazime dhe një fitore për Tiranën, e

ardhur pikërisht në Korçë. Statistikat janë gjëja e fundit që shqetëson trajnerin Shehi në këto momente. Si gjithnjë gjatë këtij sezoni, Shehi e ka pasur shumë të vështirë të zgjedhë. Shpesh për shkak dëmtimesh e shpesh për shkak kartonësh, nuk e ka pasur thuajse kurrë në dispozicion grupin e plotë. Në këtë sfidë duhet të bëjë llogaritë pa dy lojtarë titullarë shumë të rëndësishëm si Marko Radas dhe Bruno Dita, të dy të pezulluar për shkak kartonësh.

Fjalëkryqi (1)



38. Satelit i Jupiterit.
39. Fillojnë matjet.
41. Në krye tëv idealisatëve.
42. Një Ibrahim violinist.
44. Ekstremer në sirtar.
45. Kështu shtë lojtari i under 21.
47. Eshhtë gjuajlja personale.
49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
50. Gëlonin nga gladiatorët.
VERTIKAL
1. Eli këngëtare.
2. Pak ekologjike.
3. Rastis në kufij.
4. Janë temperuraturat më të ulëta.
5. Inicialet e Lendl.
6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
7. Campion regjisore.
8. Gabim rrjete në tenis.
11. Janë si cilësi.
12. Ishite gjuha e romakëve.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. I vihet kalit.
18. Rrapo i luftëtarëve.
19. Aktet pa kufij.
20. Mbyllet me dorëzë.
21. Eshhtë periudha e ftohtë.
23. Në krye të komandës.
24. Një artist si Tristan Tzara.
28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
31. Hapin pak kufij.
32. Qethen me qen.
35. Një mendim.
36. Kusturica, regjisore.
37. Parajsja e humbur.
39. Një stacion i famshëm orbital.
40. Pak aromatike.
43. Pak interesante.
46. Lirë në qendër.
48. Nota e diapazonit.


- HORIZONTAL
1. Ishite dekret i sulltanit.
8. Fillojnë nazet.
9. Eshhtë bosht.
10. Eshhtë studio e Barack Obama-s.
13. Fillojnë romanin.
14. Pak nepozitëm.
17. Mbahen për të ndaluar.
18. Janë njerëz me dy faqe.
21. U mbiqajit Princi i oratorëve.
22. Nofka e Eisenhoëer.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
27. Kush është... nuk është i lirë.
29. Bën be pa u betuar një e tillë.
30. Kështu mbyllet dera.
33. Eshhtë për medaljen e parë
34. Janë nofka.

Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL
1. Bunuel regjisore.
4. Të parat në sport.
6. Rodrigues që këndonte fado.
11. I famshmi Pacino.
12. Kujdeset në... ekstreme.
14. Eshhtë skllavëri.
16. Eshhtë shtypi jo përditshëm.
18. Janë tek në banka.
20. Eshhtë ndeshje e... fundit.
21. Lumi i Bernës.
23. Janë me numër ato ushtarake.
24. Nesti pa pa çifte.
25. Si gjithë.
26. Sipërfaqe e shkurtër.
27. Ato të peshkut janë pa vlerë
28. Janë marifete... me grim.
31. Ethet e tij zunë kërkuesit.

32. Skuadra merengue.
33. Eshhtë trofet që fitohet.
34. Ndahen nga ortakët.
36. Një biçikletë dyshe.
39. Qetësonte delin.
42. Kanë dhoma që zihen.
44. Eshhtë ekulibri në palestër.
46. Në krye të jurisë.
47. Numri i kuartetit.
48. Gjysmë armate.


- VERTIKAL
1. Gjysma e lapsit.
2. Përfundojnë pingul
3. Shkruhen për filma.
5. Duhet realizuar.
6. Gabim pa kufij.
7. Portokalli i Stanley Kubrick.
8. Në krye të artistëve.
9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
10. Fleming që krijoi James Bond.
13. Janë binarë.
15. Janë dhoma.
16. Eshhtë i zi... pikant.
17. Institucione Lokale Tiranë.
19. Pagëzoi Shën Palin.
20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për... gol.
27. Një fjalë për më vonë.
29. Maria Rilke, shkrimtar.
30. Fillojnë turnin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë copë... torte.
35. Mbyllin një tender.
34. Ndo në kufij.
38. Një pëlthurë.
40. Lidh dy brigjet.
41. Një pije piratësh.
43. Fillojnë lehtë.
45. Të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			1 7					5
								9 3
					2 4			
1 9			8					2
		6 2						
4			3					5
				9				7
	4		5 6					8
3								

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3 1 5 7 4 8	2 6 9
2 4 7 1 6 9	8 3 5
6 8 9 3 2 5	4 7 1
4 6 8 5 7 1	3 9 2
9 3 1 2 8 4	7 5 6
7 5 2 6 9 3	1 4 8
5 2 6 8 3 7	9 1 4
8 7 4 9 1 6	5 2 3
1 9 3 4 5 2	6 8 7




Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Kush jeton sipas të gjitha rregullave humb gjithë kënaqësitë.
- Çmenduri është të bësh gjithmonë të njëjtën gjë dhe të presësh rezultate të ndryshme.
- Disa njerëz janë shumë të varfër, gjithçka që ata kanë janë paratë.
- Që ti thuash të vërtetën dikuj që nuk të kupton, ndonjëherë është më keq sesa ta gënjesh.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



Thënie të mençura

- Forca e vullnetit është ajo që ju detyron të fitoni, kur logjika juaj thotë se ju keni humbur.
- Një grua e bukur është ferr i shpirtit, pastruese e xhepit, dhe parajsë e syve.
- Një njeri i kompletuar ka qetësi për të pranuar gjërat që nuk mund të ndryshojë, ka fuqi për të ndryshuar gjërat që mundet dhe mençurinë për të kuptuar diferencën.

